

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7843 E shtunë 6 Prill 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Dje
në "Koha Ditore"
Është një barsolë e vjetër, bile kaq e vjetër, sa që ka kohë që nuk tregohet. Vetëm citohet fundi i saj në formë pyetjeje: "S je me mu, a me arushën?", dhe ...
Vijon në faqen 20

Nga VETON SURROI
Elaborimi në Shqipëri dhe Kosovë i ideve të Dobrica Qosiqit


Opinion
i Ditës
Edhe pse u rritëm me mbi 4 për qind vitin e kaluar, tremujori i katërt tetor-dhjetor 2018 pësoi ngadalësim në rritje, nga një mot jo me reshje të ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI
Rritja ekonomike: në dorë të Zotit apo lekut?




Reagon MEPJ shqiptare: E vërteta e bisedës
Ciprasi telefoni Edi Ramën, grekët: Si e ndryshoi qeveria vendimin për pronat

Ishte: Pronat shtetërore regjistrohen para privatit. Bëhet: Privati, më pas shtetërore
Dy ditë më parë kryeministri Edi Rama zhvilloi një bisedë telefonike me homologun e tij grek, Aleksis Tsipras. Ndërsa nuk pati një deklaratë zyrtare nga ana e qeverisë shqiptare, mediat greke raportuan se biseda e kryeministrit Tsipras me homologun e tij shqiptar u përqendrua në vendimin mbi pronën në bregun e Jonit dhe në Aktin e Minoriteteve ...
Në faqen 5

EMRAT/ AGJENCIA E TRAJTIMIT TE PRONES: PARATE PER 600 FAMILJE PRONARET, ATP: SI NDAHEN 2.8 MILIONË EURO KOMPENSIM

Familjet që marrin paratë në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Lezhë dhe Vlorë. Pronarët duhet të plotësojnë formularin dhe të dorëzojnë trashëgiminë



(Në foto) Ndertime informale në Tiranë

FUSHATA
Rama prezanton Gjicin në Kukës. Basha: Deputetët e PD do të zgjidhen "online"
Në faqet 3-4

DEBATI
Krizja, BE: Palët duhet të bashkohen. Opozita: Drejtësia në vend, e kapur
Në faqen 2

UNIVERSITETI
"Bujqësori" në 'sherr' me bashkinë, rektori: Qeveria na premtoi pronat
Në faqen 11

"BLUETOOTH"
Të rejtat e fundit nga bota e muzikës dhe "showbizz-it", foto dhe intervista
Suplement

INTERVISTA

Eda Gemi, kandidatja shqiptare e PASOK-ut grek për anëtare e Parlamentit European
Në faqen 10

Leksioni i hapur i Terry Trayvick: Strategjitë për të pasur sukses
Fitimet në biznes, eksperti amerikan te "Luarasi"
Mateo Spaho: Vlerësojmë kontributin ndërkombtar të profesorit

NGA VOLTIZA DURO
Në kushtet e një mjedisi të ndryshueshëm me konkurrencë intensive, sukcesi i biznesit shumë herë mund të jetë i rishikuar. Por, strategjitë e duhura të qëndrueshme afatgjata si dhe stafi profesionist mund të



luajnë një rol të rëndësishëm në të ardhmen e një biznesi. Për të njohur më mirë planet dhe investimet që duhen ndërmarrë, studentët e Ekonomikut në universitetin "Luarasi" kanë patur mundësinë të ndjekin leksionin e hapur nga ...
Në faqen 11

KRIZA POLITIKE DIALOGU

Drejtoresha e BE për Ballkanin: Qeveria të përparojë për rekomandimet e ODIHR

Kriza, BE: Koha që palët të bashkohen për të mirën e vendit

"Çdo qeveri demokratike duhet të dëgjojë kritikën"

Valentina Madani

Bashkimi Europian pret që në Shqipëri të fillojë dialogu mes opozitës dhe opozitës për zgjidhjen e krizës politike në vend. Zyra e delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë apeloj dje palët politike për t'u ulur në dialog për zgjidhjen e ngërçit politik. Pasi drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Genoveva Ruiz Calavera, takoi kryeministrin pasditen e së enjtes dhe përfaqësues të opozitës dje, Delegacioni Europian në Tiranë u bëri thirrje mazhorancës dhe opozitës që të dialogojnë për zgjidhjen e krizës politike. Në Illoarinë e tij zjartare në "Twitter", delegacioni u kërkon të bëhen bashkë për të mirën e vendit. "Është koha që palët politike të bëhen bashkë për të mirën e përbashkët të vendit. Ruiz Calavera u takua me përfaqësues të partive opozitare për të shkëmbyer pikëpamjet mbi situatën politike në Shqipëri, përpara raportit vjetor të Komisionit të 2019", - thuhet në reagimin e delegacionit të BE-së në Tiranë. Gjatë ditës së djeshme, misioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Genoveva Ruiz Calavera takoi përfaqësues të partive opozitare në Tiranë, ish-deputetët Oerd Bylykbashi dhe Aldo Bumçi. Në takim mësohet të jetë diskutuar për situatën politike në Shqipëri, pak përpara publikimit të raportit vjetor të Komisionit Europian për vitin 2019, në muajin maj. Drejtorja për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Genoveva Ruiz Calavera, në një postim në rrjetet sociale shkruan se Bashkimi Europian pret që në Shqipëri të fillojë dialogu ndërpartiak në mënyrë konstruktive. Calavera theksoi se është shumë e rëndësishme për Shqipërinë që të përparojë me shpejtësi në zbatimin e



DEKLARATA

"Çdo qeveri demokratike duhet të dëgjojë kritikën e shoqërisë civile. Autoritetet duhet të hapin rrugë për dialog, për reforma me të gjithë aktorët e shoqërisë civile. Procesi i vettingut nuk do të ishte i mundur pa rolin dhe monitorimin e këtyre aktorëve", - theksoi zj.Genoveva Calavera.

Opozita i ankohet shëfës së ONM-së: Drejtësia po kapet, veting me dy standarde

Ish-deputetët e opozitës, sipas takimit kanë harruar mbi tavolinë një dokument të mbushur me pakënaqësi, sesi po ecën reforma në drejtësi. Ish-deputetët e opozitës iu ankuan zonjës Calavera për mënyrën sesi u zgjodh Arta Marku prokurorë e përgjithshme e përkohshme. Ankesat kanë vijuar me anëtarin e KLP-së, Bujar Sheshi, si bashkëpunëtor i ish-Sigurimit, përishi çështjen e transferimit të prokurorëve që hetuan ish-ministrin Tahiri. Po ashtu, ish-deputetët e opozitës folën në këtë takim edhe për Donika Prelën, që sipas tyre është kontestuar gjatë vettingut. Për Donika Prelën, ata thanë se dyshohet se i është hequr viza amerikane, fakt që nuk e ka reflektuar në formularin e



vettingut. Sipas ish-deputetëve të opozitës, kjo ka ardhur pasi Komisioni i Ligjeve ka adaptuar procedura që nuk ekzistojnë askund për të kapur sistemin. Një tjetër shqetësim drejtuar Calaverës, që ish-deputetët e opozitës kanë ngritur, është gara për kryeinspektor të ILD-së, ku sipas tyre kandidatët Metani, Kokona dhe Gjonçaj kanë lidhje direkt me PS-në. Nuk ka munguar në këtë takim edhe shpalosja nga ish-deputetët e PD-së të biografive të anëtarëve të KLP-

së. Deputetët e opozitës i kanë kërkuar shëfës së ONM-së se, që roli këtij organizimi në raportet reformën në drejtësi duhet rëdimensionuar, në mënyrë që të respektohet maksimalisht rëndësia që i është dhënë ONM-së dhe rekomandimet e saj të mos zhvlerësohen. Sipas bashkëbiseduesve të zonjës Calavera, transparenca lidhur me rekomandimet e ONM-së është zero, pasi nuk gjenden të publikuara në faqet e KPK-së, KPA-së apo KP-së.

rekomandimeve të ODIHR-it. "Ndërkohë që BE-ja pret që dialogu ndërpartiak të rifillojë në mënyrë konstruktive. Është shumë e rëndësishme për qeverinë që të përparojë me shpejtësi në zbatimin e rekomandimeve të ODIHR-it nën kompetencën e saj të drejtëpërdrejtë. EU in Albania", - shkruan Calavera në "Twitter". Gjatë vizitës së saj dyditore, shëfja e ONM-së,

Genoveva Calavera, ka zhvilluar takime me kryeministrin Edi Rama, me ministrin e Drejtësisë dhe anëtarët të KLP-së, me fokus reformën në drejtësi. Zyrtarja e Lartë e Brukselit nuk ka preferuar të flasë mbi situatën politike dhe ecurinë e reformës në drejtësi 3 muaj para vendimit për hapjen e negociatave. Genoveva Calavera ka zgjedhur që të gjitha shqetë-

simet e Unionit në lidhje me Shqipërinë t'i paraqesë në takimet kole me kokë me liderët e politikës. Reforma zgjedhore është vendosur si kusht për çeljen e negociatave dhe Calavera vjen në Tiranë në këtë vizitë dyditore për t'u njohur me qëndrimet e palëve për situatën politike në Shqipëri përpara përgatitjes së raportit të vitit 2019. Nuk ka ende asnjë re-



Drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, Genoveva Ruiz Calavera dhe përfaqësues të delegacionit evropian në Tiranë

ANKESA

Ish-deputetët Bylykbashi dhe Bumçi folën në takimin me zj. Calavera edhe për Donika Prelën, që sipas tyre është kontestuar gjatë vettingut. Për Prelën, ata thanë se dyshohet se i është hequr viza amerikane, fakt që nuk e ka reflektuar në formularin e vettingut.

Vetëdekonspirohen ankesat e PD në takimin me shëfën e ONM-së

Genoveva Ruiz Calavera, shëfja e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) zhvilloi dje një takim me përfaqësuesit e opozitës. Zyrtarisht delegacioni i BE-së në Tiranë publikoi foto nga takimi duke thënë se ka ardhur koha për dialog, por pa dhënë detaje se çfarë është diskutuar. Ish-deputetët e opozitës nuk janë treguar të kujdesshëm, sepse pas takimit kanë harruar mbi tavolinë një dokument të mbushur me pakënaqësi sesi po ecën reforma në drejtësi. Në takim kanë qenë ish-deputetët Silva Caka, Klajda Gjoshja, Oerd Bylykbashi dhe Aldo Bumçi. Letra është publikuar nga "Top Channel", ku që në fillim ish-deputetët e opozitës i ankojnë zonjës Calavera për mënyrën sesi u zgjodh Arta Marku prokurorë e përgjithshme e përkohshme. Ankesat kanë vijuar me çështjen e transferimit të prokurorëve që hetuan ish-ministrin Tahiri. Po ashtu, ish-deputetët e opozitës kanë folur në këtë takim edhe për Donika Prelën, që sipas tyre është kontestuar gjatë vettingut. Për Donika Prelën, ata kanë thënë se dyshohet se i është hequr viza amerikane, fakt që nuk e ka reflektuar në formularin e vettingut. Një tjetër shqetësim drejtuar Calaverës në letërën e publikuar nga "Top Channel", është gara për kryeinspektor të ILD-së, ku sipas tyre kandidatët Metani, Kokona dhe Gjonçaj kanë lidhje direkt me PS-në. Nuk ka munguar në këtë takim edhe shpalosja nga ish-deputetët e PD-së të biografive të anëtarëve të KLP-së.

agim nga opozita pas miratimit të Kuvendit të paketës "Gjiknuri", që i jep mundësi në Komisionin e Posaçëm të Reformës Zgjedhore partisë më të madhe të opozitës të ketë hapësirë e saj për të bërë propozime për amendimin e Kodit Zgjedhor. Bashkimi Europian i ka dhënë të gjithë besimin shoqërisë civile, pa të cilën, sipas drejtoreshës së Ballkanit Perëndimor në

Komisionin Europian, nuk do të ishte bërë i mundur procesi i vettingut. "Çdo qeveri demokratike duhet të dëgjojë kritikën e shoqërisë civile. Autoritetet duhet të hapin rrugë për dialog, për reforma me të gjithë aktorët e shoqërisë civile. Procesi i vettingut nuk do të ishte i mundur pa rolin dhe monitorimin e këtyre aktorëve", - theksoi zj.Genoveva Calavera.

REDAKSIONI: Redaktor i Suplementeve dhe Sociale: Rezarta Delisula, Redaktor i Rrethëve: Trëndafille VISHA, Redaktor i Kulturës: Fatmira Nikolli, Art Designer: Nevila SAMARXHI.

ADMINISTRATA: Përgjegjës e Financës: Alma Smokthina 0682074397, Shpërndarja: Elvis Ljaka Cel 0682074416, Marketingu: Cel:0688087823 -email:marketing@gazetashqiptare.com, ADRESA: Ish-Drejtorja e Uzinës së Autotrafikut, Tiranë - Tel:(04) 2359-104 Tel&Fax:(04) 2359-116 Marketingu: Tel:(04) 2359-104/359-123. Tiranë, Internet: www.balkanweb.com, Email: gazetashqiptare@hotmail.com; redaksia@gazetashqiptare.com, SHTYPUR në "Klasik"Shpk



Mazhoranca është e gatshme që të ulët në tryezën e bisedimeve me opozitën, por vetëm sa i përket realizimit të reformës zgjedhore. Pas apelit që bëri drejtoresha për Ballkanin Perëndimor, Genova Ruiz Calavera, gjatë ditës së djeshme, kryeministri Edi Rama u shpreh se shumica qeverisëse ishte dakord që të ulët të dialogonte me opozitën, por duke vënë si kusht vetëm çështjen e Kodit Zgjedhor. Njëpër një statusi në rrjetet sociale ai theksoi se ishte plotësisht dakord që mazhoranca dhe opozita të ulerin të dialogonin për çështjet dhe shqetësimet që ajo kishte ngritur më parë dhe që kanë të bëjnë me votimin, numërimin apo edhe forcimin e Kodit Penal sa i përket veprës së shitblerjes së votës. "Plotësisht dakord me del-

Kreu i qeverisë reagoi pas apelit të ndërkombëtarëve

Rama: Dakord për dialog, por vetëm në tryezën e reformës zgjedhore



Kryeministri Edi Rama

egacionin e BE: Koha që palët të dialogojnë! Reforma Zgjedhore, vota e emigrantëve, votimi/numërimi elektronik, penaltitetet e reja për shitblerjen e votës, du-

het të na bëjnë bashkë. Kush iku nga Kuvendi, ka ende vend në tryezën e reformës me status të barabartë!". - tha Rama. Në fakt me këtë deklaratë ai nuk ka

ofruar asgjë më shumë sesa ofroi edhe gjatë seancës së fundit parlamentare, ku mazhoranca miratoi një vendim që i jepte PD-së një status të barabartë PS-në në komisionin e reformës, pavarësisht se ajo tashmë nuk është më një parti parlamentare. Ndërkohë që drejtoresha për Ballkanin Perëndimor, Genova Ruiz Calavera zhvilloi një vizitë në Tiranë dhe njëpër një postimi në "Twitter" theksoi se pret nisjen e dialogut ndërpartiak. "BE pret që dialogu ndërpartiak të rifillojë. BE pret rifillim të dialogut në mënyrë konstruktive. Qeveria të përparojë në rekomandimet e ODIHR-it", shkroi Calavera.

Kreu i qeverisë i premtoi Kukësit ndërtimin e aeroportit dhe stadiumit të ri

Safet Gjici do jetë kandidat i Partisë Socialiste për kryetar të Bashkisë së Kukësit. Kryeministri Edi Rama ka shuar çdo dyshim në lidhje me Bashkinë e Kukësit, ndërsa gjatë takimit të radhës "Bashkia që duam" u shpreh se presidenti i klubit të futbollit të Kukësit tashmë do të jetë dhe kandidat për kryetar bashkie të këtij qyteti. "Kandidatin për kryetarin e Bashkisë, nuk e sollëm ne, por e gjetëm midis jush. E gjetëm dhe është kampion, ose të paktën për kampion. Të paktën po të mos fitoni kampionatin, të fitoni Bashkinë. Besoj se jeni dakord që Safet Gjicin ta keni kryetar Bashkie. Nuk diskutohet që shumë gjëra janë bërë dhe shumë të tjera do bëhen akoma më mirë. Ka vetëm një forcë që mund t'i bëjë gjërat. Është PS. Nëse keni nevojë për një ndihmë do më thërrisni mua se Lulin do e gjeni gjumë. Unë rri deri në tre të natës", - u shpreh Rama. Ai theksoi se është momenti që qytetarët e Kukësit të votojnë për kandidatin PS-së, pasi vetëm kështu qeveria do ketë më shumë mundësi të bëjë më shumë për Kukësin. "Ka ardhur koha që bashkinë të na e jepni ne, si detyrë për të bërë për Kukësin shumë gjëra që nuk janë bërë" -tha Rama. Më tej ai u shpreh se qeveria do të vijojë punën për ndërtimin e aeroportit dhe stadiumit të këtij qyteti, dy vepra këto që sipas tij do të hapin shumë vende pune për qytetarët e Kukësit. "Aeroporti është në një pozicion shumë strategjik, sepse mbledh shqiptarët këtej dhe andej kufirit. Do i japë mundësinë çunave të Kukësit të vijnë me shumë pak paund. Parashikohet një fluks prej rreth 300 mijë

Rama prezanton Safet Gjicin: Kampioni do fitojë bashkinë

Aeroporti do ketë 1 milion udhëtarë



Kryeministri Edi Rama, dhe në Kukës

pasagjerësh në vitin e parë për të shkuar deri në 1 milion pasagjerë në vit. Është një projekt që na jep garancinë se do të jetë edhe një gjenenerator vendesh pune. Çdo dollar në aviacion përkthehet në 4 dollar përfitim. Ky aeroport do të sjellë një erë të re zhvillimi për të gjithë zonën", - tha Rama. Gjithashtu, ai tha se edhe

punimet për stadiumin do të nisnin shumë shpejt. "Jemi duke përfunduar edhe projektin e stadiumit. Sepse Kukësi e meriton një stadium. Investimi edhe aty do të kryhet siç jemi zotuar. Së shpejt do të jemi këtu për të filluar punën për ndërtimin e stadiumit. Me ndërtimin e tij do t'i prisni këtu miqtë që do vijnë. Besoj ka ardhur

koha që Bashkinë të na e jepni ne, si detyrë për të bërë për Kukësin shumë gjëra që duhet të ishin bërë me kohë dhe për të dalë nga një situatë që duhen katër muaj për të marrë leje për spitalin", - tha Rama. Ai gjatë këtij takimi nuk la pa sulmuar edhe opozitën, për të cilën tha se edhe rrugën e kombit e la përgjysmë. "Ata thonë se bënë shumë rrugë dhe i lanë rrugëve. Kjo rrugë është gjëja më e mirë që kanë bërë, por edhe këtë e lanë rrugëve. Siç lanë rrugët rrugëve kanë lënë dhe veten rrugëve. Kush i tha të ikin nga parlamenti. Mirë që ikin po pse duan të futen me zor", - tha Rama. Ai tha se e kishte mundur PD-në në zgjedhje kur ajo kishte edhe pushtetin. "Si qenka kjo që Saliun me shtetin dhe policinë e mundëm pa pasur gjë në dorë, e nuk mundim dot Lulin tani që i kemi të gjitha", shtoi Rama. Në fjalën e tij nga Kukësi, kryeministri Edi Rama ka komentuar edhe protestën e disa militantëve të PD, të cilët bllokuan rrugën në hyrje të qytetit për të mos e lejuar kalimin e tij. "Traditën e mikpritjes e keni shumë të fortë, edhe pse disa dalin te rruga. E dimë që pyll pa derra s'ka", - tha Rama.



Përkrahësit e PD bllokuan rrugën dhe çanë kordonin e policisë

Siç është bërë zakon tashmë në të gjitha qytetet, kryeministri Edi Rama edhe dje në Kukës është pritur me protesta nga disa prej banorëve dhe militantëve të PD-së. Pjesë e këtyre protestave ishte edhe kryetari i Bashkisë së Kukësit. Ata bllokuan fillimisht urën në afërsi të Drinit të Zi me qëllim që të mos kalonte kryeministri. Ndërkohë që PD deklaroi se kryeministri shmangu kalimin në këtë rrugë, duke shkuar në Kukës me helikopter. Më pas protestuesit marshuan në këmbë drejt aeroportit, ndërkohë policia u angazhua për të mbajtur nën kontroll situatën. Ata arritën të çajnë kordonin e policisë, ku dhe janë afëruar tek aeroporti. Nga ana tjetër, kryetari i Bashkisë së Kukësit Bashkim Shehu në një prononim për media denoncoi gjunën raciste që Edi Rama përdori ndaj qytetarëve të Kukësit. Fill pas këtyre protestave reagoi kryeministri Rama, i cili e cilësoi kryetarin e Bashkisë Kukës qesharak për faktin që i ka zënë rrugën me administratën. "Një kryebashkiak qesharak i një partie qesharake del e zë rrugën e Kukësit me administratën, në vend se të ishte me mijëra qytetarë kukësi në çeljen e punimeve të aeroportit ndërkombëtar! Merren me prita rrugësh në shekullin e XXI e pastaj duan vota nga ky popull. Oh ç'derexhe!" - shkroi Rama.

KANDIDATI
"Kandidatin për kryetarin e Bashkisë, nuk e sollëm ne, por e gjetëm midis jush. E gjetëm dhe është kampion, ose të paktën për kampion. Të paktën po të mos fitoni kampionatin, të fitoni Bashkinë. Besoj se jeni dakord që Safet Gjicin ta keni kryetar bashkie. Nuk diskutohet që shumë gjëra janë bërë dhe shumë të tjera do bëhen akoma më mirë. Ka vetëm një forcë që mund t'i bëjë gjërat. Është PS."

AKSIONI I OPOZITËS TAKIMET

Mbërrijnë konservatorët britanikë, vendimet e para pasi PD të vijë në pushtet

Zgjedhjet, Basha: Kandidatët për deputetë do të zgjidhen 'online'

"Jo më kriminelë dhe ata që duan të bëjnë para"

Valentina Madani

Një grup pune nga Partia Konservatore Britanike do të ndihmojë Partinë Demokratike në modernizimin e saj, duke nisur me modeline ri të përzgjedhjes së kandidatëve si dhe me bazën ligjore për krijimin e një ligji modern për arsimin e lartë. Kreu i PD-së, Lulzim Basha, i pranishëm në një bashkëbisedim me studentët, foli për një sistem të ri të përzgjedhjes së kandidatëve të PD-së. Basha bëri të qartë se nuk do ketë kriminelë dhe as njerëz që duan të bëjnë para në listat e kandidatëve të PD-së. Basha prezantoi sistemin e ri të përzgjedhjes së kandidatëve, duke theksuar se kërkon demokratizimin e PD dhe ka mbështetjen e partnerëve perëndimorë. Sipas tij, ky sistem e hap Partinë Demokratike.

KANDIDATËT

PD-ja do të publikojë "online" formularin për ata që duan të aplikojnë për kandidatë për deputetë apo kryetarë bashkie. Sipas Lulzim Bashës, në këtë mënyrë do t'u jepet mundësia të garojnë të gjithë atyre që kanë interes të përfaqësojnë politikisht qytetarët, ndërsa shtoi se do t'u pamundësohet garimi i njerëzve me rekorde kriminale, apo njerëzve që sipas tij, vijnë aty me para për të shumëfishuar paratë e tyre. "Unë jam i vendosur ta demokratizoj dhe modernizoj PD-në dhe për këtë kam mbështetjen e botës perëndimore, të Partisë Konservatore, të Partisë Kristiane-demokrate, të Partisë Republikane të SHBA. Sistemi që ne do të adoptojmë është një sistem që e hap PD-në. E hap ndaj çdokujt që ndan vlerat tona dhe i jep mundësi përmes garës që të kontribuojnë. Që të ndryshojë politika, duhet të ndryshojnë partitë politike. Nëse brenda partive e gjithë vendimmarrja është në dorën e një njeriu, në rastin konkret të kryetarit të partisë që bën listën e deputetëve, ashtu do të jetë nesër edhe shteti, në dorën e një njeriu. Ne do t'i japim fund kësaj praktike, duke nisur brenda PD-së sot dhe nesër në qever-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

KANDIDATËT

"Nesër, pasnesër ju do ta shikoni vetë kur PD-ja do të botojë 'online' formularë të aplikimit për ata që dëshirojnë të jenë kandidatë në zgjedhjet e ardhshme në emër të PD. Do të jetë merita, që do të përcaktojë se kush do të jetë ai apo ajo që do të përfitojë përmes votës së lirë dhe vlerësimit transparent që do të përfaqësojë PD në një parlament të çliruar nga krimi dhe kriminelët", deklaroi z.Basha.

NJË TJETËR DEMOKRAT KËRKON MANDATIN E DEPUTETIT

Kryetari i FRPD-së Ersekë, Arlind Çarçani, është kandidati i radhës që kërkon mandatin e deputetit. Ai dorëzoi dje formularin e dekriminalizimit në KQZ. Bashkë me Çarçanin shkon në 102 numri i deputetëve. Dy ditë më parë, Korab Lita mori mandatin nga KQZ-ja dhe pritet të botohet në seancën e radhës plenare, ndërsa Halli Jakimi do të marrë mandatin, pasi të pranohet dorëheqja e tij si këshilltar bashkiak në Bulqizë.

"Më pak subvencione", Kryemadhi: Bujqësia dhe blegtoaria, në gjendje të mjerë



ton. Është ulur 7 herë më shumë subvencioni për ta. Jo vetëm për ta, por për të gjithë bujqësinë shqiptare. Problemi qëndron që shteti nuk i shikon më blegtorët dhe fermerët shqiptarë si part-

nerë, por i shikon si armiq. Pak më përpara një stallë që e ndërtonim për gjënë e gjallë, shteti vinte për t'ua shkatërruar, jo për t'i ndihmuar. Situatë është shumë e mjerë në ekonominë shqiptare, por



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë takimit të djeshëm me studentët

PETRIT VASILI

Nënkryetari i LSI, Petrit Vasili, reagoi dje ashpër ndaj ndërkombëtarëve. Në një postim në "Facebook", ai shkruan se ata po bëjnë "hapa pas", ndërsa shton se po shfaqen "çuditërisht", sipas tij, në rolin e krijuesve të alibive në vend të stimulimit të demaskimit dhe ndëshkimit.

YLLI MANJANI

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, e cilëson të papranueshme ftesën e kryeministrit Edi Rama për opozitën, për reformën zgjedhore, për sa kohë sipas tij është një parlament monist. Manjani shprehet se sistemi zgjedhor duhet ndryshuar, por së pari vendi ka nevojë për një parlament pluralist.

drejtimin e vendit, Partia Demokratike do të synojë abrogimin e një ligji të ri për referendimet, me qëllim që të ndalë hajdutët që ndërtojnë pa votë fabrikat e vdekjes në Tiranë, Elbasan apo Fier. "Duhet të fuqizojmë rolin e qytetarëve. Ata duhet të kenë mundësinë të shprehin për çështje të rëndësishme. Por, ligji i sotëm për referendimet e pamundëson këtë. Imagjinooni për një moment nëse do të kishim mundësi të zhvillim një referendum për Teatrin Kombëtar. Të gjithë ata që ngrehen si gjela me një gjuhë vulgare se do ta prishim, po bëhet një vit që atje proteston elita kulturore e Shqipërisë, për të mbrojtur jo shtëpinë e tyre, por shtëpinë e të gjithë artist shqiptar, me vlera të jashtëzakonshme. Po të kishim një referendum të Tiranës apo të të gjithë Shqipërisë, do t'u kishim treguar vendin. Ligji për Teatrin do të binte dhe ata që e kishin hartuar atë, do të detyroheshin të largoheshin nga pushteti. E njëjta gjë për inceneratorët. Pse nuk shprehen dot qytetarët e Elbasanit për fabrikën e vdekjes që u ka ngritur Arben Ahmetaj atje? Apo të Fierit? Apo të Tiranës? Vjedhin lekët e shqiptarëve dhe ndërtojnë fabrikat që helmojnë shqiptarët, sepse nuk kemi mundësi t'i kundërshtojmë në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

isje", tha z.Basha. "Me procesin e zgjedhjes së kandidatëve - shtoi ai - ne do të ndjekim modelin evropian, do të pamundësojmë që çdokush që ka interes të përfaqësojë politikisht qytetarët, komunitetin, në çdo nivel, kryebashkiak apo deputet të kenë mundësi të kandidojnë. "Do ta bëjmë këtë duke u pamundësuar kandidimin personave

me rekorde kriminale apo atyre që nuk janë të aftë. Britanikët po na ndihmojnë që ne të ndërtojmë një mënyrë të zbatimit të këtyre rregullave. Nesër, pasnesër ju do të shikoni vetë kur PD do të botojë 'online' formularë të aplikimit për ata që dëshirojnë të jenë kandidatë në zgjedhjet e ardhshme në emër të PD. Do të jetë merita, që do të përcak-

tojë se kush do të jetë ai apo ajo që do të përfitojë përmes votës së lirë dhe vlerësimit transparent, që do të përfaqësojë PD në një parlament të çliruar nga krimi dhe kriminelët", theksoi z.Basha. Kreu i PD-së foli për lista të hapura: "Ka ide të vlefshme si listat e hapura, ku qytetarët të vendosin jo thjesht për siglat e partisë, por të ven-

dosin kë preferojnë nga lista e deputetëve, për një parlament që ka deputetë që e lidhin fatin me qytetarët. Kjo është garanci që u shërben interesave të qytetarëve".

VENDIMI

Kreu demokrat, Lulzim Basha, bëri një premtim tjetër nga takimi i djeshëm me studentët e Politeknikut. Basha tha se me të ardhur në



Pronat shtetërore do të regjistrohen pasi të jenë regjistruar pronat private

Rama-Tsipras, qeveria miraton VKM-në, favorizon pronarët në bregdet

MEPJ zbardh telefonatën mes dy kryeministrave

Dy ditë më parë kryeministri Edi Rama zhvilloi një bisedë telefonike me homologun e tij grek, Aleksis Tsipras. Ndonëse nuk pati një deklaratë zyrtare nga ana e qeverisë shqiptare, mediat greke raportuan se biseda e kryeministrit Tsipras me homologun e tij shqiptar u përqendrua në vendimin mbi pronën në bregun e Jonit dhe në Aktin e Minoriteteve. Ndërkohë që dje burime nga qeveria jonë kanë zbardhur një pjesë të bisedës së zhvilluar, duke theksuar se nuk bëhej fjalë për një telefonatë urgjente, por të programuar që më parë. "Biseda telefonike mes kryeministrit Edi Rama dhe homologut të tij grek, Aleksis Tsipras, ka qenë e planifikuar për t'u kryer prej kohësh", - thanë burime nga MEPJ, lidhur me bisedën mes dy kryeministrave. Të njëjtat burime theksuan se çështja e të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri është e përhershme në bisedat mes tyre dhe kjo nuk ka asnjë lidhje me çështjen e vendimit që bllokoi veprimet ligjore për regjistrimin e pronave në bregdet, përfshi edhe zonën e Himarës. Sipas burimeve nga Ministria e Jashtme, nuk ka një vendim apo akt të posaçëm të qeverisë shqiptare për pronat e minoritetit grek në Himarë. "Çështja e të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri është e përhershme në bisedat mes dy kryeministrave dhe çështja e lidhur me pronën në bregdet është e qartë. Nuk ka pasur asnjë vendim të posaçëm lidhur me pronat e minoritarëve dhe vendimi i marrë nga qeveria për të tërë vijën bregdetare i



Kryeministri Edi Rama, me homologun e tij grek, Aleksis Tsipras

Media greke: VKM-ja për pronat, produkt i telefonatës Rama-Tsipras

Një jehonë të gjerë i kanë bërë mediat greke telefonatën mes kryeministrit Rama dhe homologut të tij grek, Aleksis Tsipras. Gazeta e madhe "Ethnos", e titulloi ballinën e së premtes "Pas vizitës në Shkup, Tsipras telefonon Ramën". Duke iu referuar burimeve nga qeveria greke, gazeta shkruante dje se Tsipras e Rama gjatë bisedës telefonike diskutuan mbi reformat që duhet të realizojë Tirana për t'u hapur negociatat e anëtarësimit në BE. Gazeta shkruan se gjatë kësaj bisede, kryeministri shqiptar ka informuar Tsipras mbi VKM-në që bën të mundur që pronat e diskutueshme do të regjistrohen nga pronarët dhe ato që do të mbeten pa pronarë do të kalojnë në administrimin e Ministrisë së Turizmit. Bëhet fjalë për vendimin e publikuar të enjten në faqen e Kryeministrit, fill pas telefonatës të Ramës me Tsipras. Sipas të përditshmes greke, ky vendim është pasojë e bisedës telefonike Tsipras-Rama.

Konferenca e OKB në Tiranë, serbët nuk pranuan të kosovarët në tryezë

Konferenca mbi klimën në Ballkanin Perëndimor në Tiranë, një organizim i Kombeve të Bashkuara, u shoqërua dje me një përplasje diplomatike Kosovë-Serbi. Delegacioni serb dhe Kombet e Bashkuara nuk kanë pranuar në tryezë delegacionin kosovar, duke kërkuar që kjo e fundit të përfaqësohej nga UNMIK. Kërkesa e tyre ka pasur në kundërshtim të përfaqësuesve nga Kosova, me pretendimin se janë një shtet i pavarur. Ministri i Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, sqaroi se ka pasur një dakordësi me OKB-në dhe me Serbinë për prezencën e Kosovës, po ata nuk ishin dakord që Kosova të kishte të drejtë vote. Si pasojë e këtij debati Klosi u largua nga konferenca së bashku me ministrin e Kosovës.

Pronat

VENDIMI

Sipas këtij vendimi, të gjitha pronat e paluajtshme shtetërore që ndodhen në zonat në të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, do të regjistrohen në përgjegjësi të Ministrisë së Turizmit, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit fillestar të pronave private në zonat kadastrale të përfshira në këtë vendim.

ka shërbyer një analizë të gjendjes së pronës në bregdet dhe identifikimit të pronave shtetërore "bregut", thanë burime nga MEPJ. Gjithashtu, ato shtuan se vendimi në fjalë bën një ndalim të përkohshëm të regjistrimit të pronave, por që nuk ka asnjë qëllim që të dëmtojë interesat e minoritetit grek. "Vendimi i ri çel procesin e regjistrimeve, tanimë mbi një bazë më solide të krijuar nga ndalimi i përkohshëm i regjistrimeve. S'ka qenë, sështë e s'do të jetë asnjëherë në interesin a në veprimet e qeverisë shqiptare, cenimi i të drejtave të asnjë minoriteti, përfshirë edhe minoritetin grek, që gëzon respekt e të drejtë të plota në Shqipëri", - theksuan burime nga MEPJ. Po sipas të njëjtave burime, dy kryeministrat diskutuan edhe për një sërë aspektesh të bisedimeve shqiptarogreke, të cilat vazhdojnë në një frymë të shëndetshme mirëkuptimi e respekti reciprok. Ndërkohë, pavarë-

Njoftim i kompanisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania njofton se duke filluar nga data **15 Prill 2019**, shërbimi Vodafone Family nuk do të jetë më i vlefshëm për klientët me parapagesë.

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni vodafone.al ose dyqanet Vodafone.

Njoftim i kompanisë Vodafone Albania Sh.A.

Të nderuar Klientë,

Vodafone Albania njofton se duke filluar nga data **15 Prill 2019**, paketat e "Krijo Paketën Tëndë" nuk do të jenë më të vlefshme për klientët me parapagesë.

Klientët me parapagesë të cilët do të kenë aktive një nga paketat e "Krijo Paketën Tëndë" në momentin e ndryshimit, do ta përdorin atë të pandryshuar deri në përfundimin e vlefshmërisë së saj.

Për më shumë informacion telefononi 140, vizitoni vodafone.al ose dyqanet Vodafone.

Merrnin para për licencën e mësimdhënies

Operacioni "Juristët e rremë", arrestohen 2 juristët mashtrues

TIRANË - Një grua 48-vjeçe dhe një i ri nga Tirana janë arrestuar nga policia gjatë operacionit të koduar "Juristët e rremë". Sipas bluve, dy të arrestuarit prezantoheshin si juristë të një institucioni kushtetues të Shqipërisë dhe mashtruan dy persona duke iu kërkuar një shumë të konsiderueshme parash, duke iu premtuar leje zhvillimore e licencë për ushtrimin e aktivitetit të mësimdhënies në një komunitet fetar: "Seksioni për Krimin Ekonomik dhe Financiar në bash-

këpunim me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, arrestuan M. F., 48 vjeçe, banuese në Tiranë, e dënua me parë për veprën penale të "Mashtimit dhe një djalë 24-vjeçar me inicialet N.Sh, banues në Tiranë. Ata u arrestuan në flagrancë nga policia në momentin që do takoheshin me dy persona të mashtruar për t'u marrë lekët", -thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, blutë bënë me dije se gjatë momentit të arrestimit, ata kanë bërë rezistencë dhe kanë kundërshtuar punonjësit e policisë. Në cilësinë e provës



materiale janë sekuestruar: Një automjet, dy aparate celularë dhe dokumente të ndryshme. Materialet procedurale i kaluan për veprime të mëtejshme Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur për veprat penale "Mashtrimi", "Falsifikimi i dokumenteve", "Përvetësimi i titujve apo i detyrës shtetërore", "Goditja për shkak të detyrës" dhe "Kundërshtimi i punonjësit të Policisë".

Shpërthen granata teksa po luanin, humb jetën 11-vjeçari, plagoset rëndë e motra

BULQIZË - Një ngjarje e rëndë është shënuar mesditën e djeshme në Fushë Bulqizë. Një fëmijë 11-vjeçar ka ndërruar jetë, ndërsa motra 9 vjeçe, është plagosur rëndë si pasojë e shpërthimit të një granate. Burime zyrtare nga policia lokale bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi në fshatin Koçaj të Fushë-Bulqizës. Mësohet se dy fëmijët e mitur kanë gjetur një granatë në një përrua, ndërsa dyshohet se granata ka shpërthyer teksa fëmijët kanë qenë duke luajtur. Për pasojë, i mituri 11-vjeçar ka humbur jetën, ndërsa e motra është plagosur rëndë. Ajo është transportuar me helikopter në Spitalin e Traumës në Tiranë, ku dhe i është nënshtruar një operacioni. Burime nga ky spital pohuan se vajza 9 vjeçe ka frakturë dhe plagë të rënda në dorën e majtë dhe në kraharor. Ndërkaq, pas sinjalizimit për shpërthimin, policia ka shkua shpejt në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për dokumentimin e plotë të saj.



Veliu takim me zyrtarë të DASH: Bashkëpunimi, çelësi i suksesit

TIRANË - Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu ka zhvilluar dje një takim me shefen e Departamentit të Hetimeve Kriminale të Shërbimit të Sigurisë Diplomatike në Departamentin e Shtetit, Karen Riley, e cila shoqërohej nga Antonio Zamudio, shef për Hetimet Kriminale në Zyrën Rajonale të Sigurimit në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë dhe Chuck Harrison, agjent Federal për Hetimet Kriminale për Ballkanin. Vizita e saj zhvillohej në kuadër të bashkëpunimit të Zyrës së Hetimeve Kriminale në Departamentin e Shtetit dhe Policisë së Shtetit. "Bashkëpunimi është çelësi i suksesit, pasi shpesh mund të kemi dëshirë e vullnet, por pa bashkëpunim dhe mbështetje nuk mund të ketë sukses. Falë këtyre dy komponentëve u bë i mundur finalizimi i dy operacioneve shumë të suksesshme "One If-By Land", në kuadër të goditjes së kontrabandimit të personave me qëllim emigrimin drejt SHBA-së, Kanadasë dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe operacionit policor "Krugua e gabuar", ku u godit grupi kriminal me 36 anëtarë të dyshuar. Policia e Shtetit e ka prioritet kryesor bashkëpunimin me partnerët, e sidomos me ata strategjikë", tha ndër të tjera Veliu. Ndërkaq, Karen Riley u shpreh se "në Departamentin Amerikan të Shtetit, janë në dijeni të operacioneve të suksesshme që janë zhvilluar në Shqipëri. Në emër të tyre ju them faleminderit. Do kemi mbështetjen tonë edhe në të ardhmen në të gjitha drejtimet".

Togat e zeza të Lezhës lirojnë 21-vjeçaren shtatzënë. I vëllai mbetet në burg

U kapën me mina me telekomandë dhe kanabis, motër e vëlla shpërthejnë në lot para gjykatës

Babai i dy të rinjve nga Vlora: Ç'më bëre, o bir Janë të pafajshëm, dyshoj se i ka përdorur dikush

LEZHË

Armand Lukani dhe Amelda Elezi nga Vlora, të cilët u arrestuan pak ditë më parë me mina me telekomandë, kanë shpërthyer dje në lot para Gjykatës së Lezhës. Vëlla e motër, përkatësisht 23 dhe 21 vjeç, në momentin që kanë zbritur nga furgoni i policisë për të hyrë në gjykatë janë përballur me babain e tyre nuk i kanë mbajtur dot lotët, ndërsa ky i fundit është shprehur me zë të mekur "ç'më bëre mor bir". Në fund të seancës gjyqësore, togat e zeza të Lezhës kanë vlerësuar të ligjëshëm arrestimin e tyre. Por, për shkak të për shkak të cilësive të veçanta, gjykata ka vendosur të nxjerrë nga paraburgimi 21-vjeçaren shtatzënë, duke vendosur ndaj saj masën e sigurisë "Arrest shtëpie". Ndërkohë që vëllai, Arman Lukani do të hetohet me masën e sigurisë "Arrest me burg". Motër e vëlla u prangosën ditën e martë sapo kishin mbërritur në qendër të qytetit të Lezhës, pasi gjatë kontrollit të ushtruar iu gjet një çantë me 3 mina të telekomanduar dhe një sasi prej 2 kg kanabis sativa. Për këtë ngjarje është shpallur në kërkim bashkëshorti i Ameldës, Esmerald Elezi. Ata akuzohen për veprat penale: "Traffikimi i lëndëve plasëse" dhe "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike". Amelda Elezi jeton në Himarë në lagjen "Spile", dhe deri në për-



Babai i dy të rinjve të arrestuar, Ilmi Lukani, duke folur për "GSH"

fundim të hetimeve nuk duhet të dalë nga shtëpia. Për shkak të shtatzënisë, në rast të nevojave urgjente mjekësore për t'u paraqitur në spital, 21-vjeçarja duhet të njoftojë policinë e Lezhës. E reja, por edhe i vëllai pretendojnë se nuk kanë lidhje as me minat dhe as me drogën. Në lidhje me këtë ngjarje ka reaguar babai i dy të rinjve. Me zërin që i dridhesh teksta ty-moste një cigare, babai i 23-vjeçarit Armand Lukani hodhi poshtë mundësinë që si minat ashtu edhe droga të

ketë lidhje me të birin. Ai mendon se vajza dhe djali janë të pafajshëm i pafajshëm dhe se mund të jenë përdorur nga dikush tjetër. Ilmi Lukani tha në një intervistë të shkurtër për "Gazeta Shqiptare" se e bija është shtatzënë, ndërsa u shpreh se nuk ka mundur t'u sigurojë një avokat fëmijëve, pasi gjendja e tyre ekonomike është e vështirë. Gjithashtu, ai deklaroi se në të kaluarën Armandi nuk ka pasur asnjëherë probleme me policinë dhe se është marrë



21-vjeçarja Amelda Elezi, duke hyrë në gjykatën e Lezhës

me bujqësi.
Zoti Ilmi, si është e vërteta?
Çuni ka qenë në punë, e dija që ishte në punë edhe më lajmëruan. Erdhi policia bëri kontroll tek shtëpia. Ata më thanë mua që është kapur me lëndë narkotike edhe me mina plasëse.
Merrej me shitje minash djali?
Jo, asnjëherë, kurrë.
Po çfarë pune bënte ai?
Punonte në bujqësi, pastrime, mbledhje bimë mjekësore në Vlorë.
Është ndaluar ndonjëherë djali juaj?
Jo, asnjëherë.
Mendimi se i ka përdorur dikush?
Po, patjetër se ku i gjeti çuni ato...
Kenë marrë ndonjë avokat...
Jo, jo se nuk kemi mundësi ekonomike.

Fidanishte kanabisi, 4 persona në pranga, procedohet kryeplaku

KRUJË - Policia e Krujës ka goditur një rast të kultivimit të lëndëve narkotike, duke vënë në pranga 4 persona. Ndërsa, kryeplaku i fshatit u procedua në gjendje të lirë. Mësohet se të arrestuarit kishin krijuar fidanishte droge, pranë lumit Tërkuzë në fshatin Nikël. "Si rezultat i kontrolleve dhe punës profesionale të kryer, janë goditur dy raste të tentativës për kultivim të bimëve narkotike, ku janë arrestuar në flagrancë 4 shtetas", thuhet në njoftimin e bluve. Mësohet se janë prangosur shtetasit: A.A., 41 vjeç dhe A.Y., 35 vjeç, të dy banues në Nikël. Gjatë kontrollit, në afërsi të lumit Tërkuzë, në këtë fshat, policia gjeti dhe sekuestroi në cilësinë e provës materiale një sasi kubikësh të mbjellë me fara, të dyshuar kanabis sativa. Po në vijim të operacionit të kontrollit të territorit, policia arrestoi në flagrancë edhe shtetasit: S.B., 26 vjeç, banues në Rinas dhe A.A., 18 vjeç, banues në Rinas. Arrestimi i tyre u bë, pasi u kapën në arën në pronësi të tyre, me një sasi kubikësh të mbjellë me fara kanabis. Gjithashtu, filloi procedimi penal për shtetasin Xh.K., 52 vjeç, banues në Rinas, sepse duke qenë kryeplaku, nuk ka raportuar se në njësinë administrative që ai ka në administrim, janë mbjellë bimë narkotike.

Nga ana e Shoqërisë "Shërbimi Permbartimor AB" Shpk është shpallur ankand i faza e dyte për pasurinë e mepostohet:
1- "Apartamenti" me sipërfaqe totale 125 m2 me Nr. pasurisë 4/63+1-42 në Zonen Kadastrale 8602. Volumi 16 Fage 109 e ndodhur në Vlorë. Cnimi fillestar për njëzet në ankand të pasurisë është 38,528 (tridhjetë e tete mijë e pesëqind e shtjet e tete) Euro.
Ankandi do të zhvillohet në datë 19.04.2019 në orën 16:00 pranë zyrës së shoqërisë "Shërbimi Permbartimor AB" Shpk me Permbartës Gjyqësor Privat Admir Beqiri të ndodhur në adresën Rr. Bul Zhan Dark Pall. Kulla. 1 Tëknoprojekt Shk.1 Kat.4 Ap.10 Tirane.

Të dyshuar për trafik droge dhe prostitucion

Europol: Goditet mafia shqiptare, mbi 60 persona të arrestuar në 5 shtete

Europol njofton se ka arrestuar 64 persona të dyshuar si anëtarë të mafias shqiptare, me veprimtari në shtetet europiane Belgjikë, Francë, Holandë, Itali dhe Britani e Madhe. Në njoftim thuhet se mbi 60 veta u arrestuan mes 3 dhe 5 prillit dhe në operacion u përfshinë mbi 600 agjentë të organizatës policore europiane. Të arrestuarit dyshohen për një sërë veprash penale, si prodhimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike, trafik i qenieve njerëzore, prostitucion dhe pastrim parash. Ky operacion u ndërmor për të goditur veprimtarinë mafioze



të shumë shqiptarëve, që vepronin në bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe që jetonin në Belgjikë, Francë, Holandë, Itali dhe Britani të Madhe. Të dyshuarit besohet se kanë menaxhuar të paktën një duzinë plantacionesh të

kanabisit të shpërndarë në të gjithë Belgjikën dhe në veri të Francës. Disa nga të dyshuarit besohet se janë përfshirë në trafik të qenieve njerëzore në shtetin francez. Nga të arrestuarit, 55 veta u vunë në pranga në Belgjikë, 7 në Holandë, 2 në Francë. Operacioni u krye në bashkëpunimin e Policisë Federale belge, Xhandarmërinë Kombëtare franceze, Policinë holandeze dhe Drejtorinë Italiane Investigative Antimafia si dhe



Policinë Britanike Metropolitanë. Europol mbështeti hetimin që nga fillimi duke lehtësuar shkëmbimin e informacionit. Në ditën e veprimt, gjashtë ekspertë të Europolit u vendosën në Belgjikë, Francë dhe Holandë për të lejuar shkëmbimin e informacionit në kohë reale. Gjatë aksionit janë bërë një sërë sekuestrimesh të aseteve kriminale. Krimi i organizuar shqiptar vazhdon të mbetet një shqetësim për vendet në Evropë, një kërcënim që Europol po e merr shumë seriozisht.

Dyshohen se janë produkt i aktivitetit kriminal ku është përfshirë 47-vjeçari

Prokuroria për Krimet e Rënda, kërkesë gjykatës: Konfiskoni pasuritë e Kelmend Balilit

Mes pasurive, edhe kompleksi luksoz "Santa Quaranta"



TIRANË

Prokuroria për Krime të Rënda ka kërkuar konfiskimin e pasurive të Kelmend Balilit, i cilësuar si "Eskobari i Ballkanit". Mësohet se organi i akuzës i është drejtuar përmes një kërkeje Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për konfiskimin e pasurisë së Balilit, i vënë nën akuzë për një sërë veprash penale. Bëhet fjalë për një truall me sipërfaqe 11.994 m² në qytetin e Sarandës, kompleksin luksoz "Santa Quaranta" (ish-Kampi i Pushimit të Punëtorëve 4+1 kate me sipërfaqe ndërtimi 1923 m² dhe sipërfaqe trualli 13.000 m²) ndodhur në qytetin e Sarandës; truall me sipërfaqe 1716.91 m² në qytetin e Sarandës, njësi me sipërfaqe 120 m² si dhe 23 apartamente. Aktualisht këto pronat janë të sekuestruara me vendim gjykatë dhe pas 18 muajsh hetime, prokuroria kërkon konfiskimin e tyre, pasi dyshohet se këto pasuri janë produkt i aktivitetit kriminal ku është përfshirë Balili. Tashmë në Gjykatën e Krimeve të Rënda pritet të fillojë procesi për këtë vendim të akuzës. Vendimi i prokurorëve vjen në një kohë ku në gjykatë është duke u zhvilluar procesi gjyqësor ndaj Kelmend Balilit. Aktualisht procesi ka ngecur, pasi për tri seanca radhazi, prokuroria nuk ka mundur të lexojë pretendencën për të pandehurin, për shkak të mungesës së avokatit Theodorhi Sollaku. Në seancë e fundit, ai u gjobit



Kelmend Balili në gjykatë

nga gjykata me 10 mijë lekë të reja. Pritet që të hënën e ardhshme prokuroria të lexojë konkluzionet e saj për Balilin, të cilin e akuzon për trafik droge, grup të strukturuar kriminal, pastrim parash dhe fshehje të pasurisë. **NJOFTIMI I PROKURORISË:** Prokuroria për Krime të Rënda në përfundim të hetimit të procedimit pasuror nr.5 datë 16.11.2017, i cili ka filluar mbi bazën e verifikimeve të kryera e


Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në kuadër të procedimit penal në ngarkim të shtetasit Kelmend Balili, i cili është akuzuar për kryerjen veprave penale "Trafikimi i narkotikëve", në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, "Pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal", "Refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë i pasurive, intereseve private të personave të



Kompleksi luksoz në Sarandë, "Santa Quaranta"

zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1, 257/a/2, 287/1 të Kodit Penal, bazuar në nenet 3, 5, 7, 15 deri në 21, 22, 23, 24, 28, vijues të ligjit Nr. 10192 datë 03.12.2009, i ndryshuar "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave paran-

daluese kundër pasurisë", ka paraqitur kërkesën për konfiskimin e pasurive të mëposhtme: Truall me sipërfaqe 11.994 m² në qytetin e Sarandës. Objekti ish-Kampi i Pushimit të Punëtorëve 4+1 kate me sipërfaqe ndërtimi 1923 m² dhe sipërfaqe trualli 13.000 m² ndodhur në qytetin e Sarandës. Truall me sipërfaqe 1716.91 m² me ndodhur në qytetin e Sarandës. Njësi me sipërfaqe 120 m² dhe 23 (njëzetetre) apartamente.



Kapen me 10 kg kokainë në makinë, përfundojnë në pranga 3 shqiptarë

ITALI - Policia italiane ka arrestuar 3 shqiptarë në Piza, pasi iu gjetën 10 kg kokainë në makinë. Në pranga të policisë kanë rënë 3 shqiptarë të moshave 38, 35 dhe 28 vjeç. Droga e sekuestruar ishte e pastër 100 për qind. Në rast se sasia e drogës të sekuestruar do të hidhej në treg, atëherë shqiptarët do të fitonin 1 milion e 200 mijë euro. Shqiptarët u arrestuan dhe do të dërgohen në gjykatë. Në këtë operacion, përpos drogës, u sekuestruan edhe dy makina, 8 telefona celularë, si dhe 4100 euro para të gatshme.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA
Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e dytë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke BKT BANK, me këto të dhëna:
Ø Pasuria "ARE" nr. 17/5, Zona Kadasrale 3339, me sipërfaqe 7780 m² faga 190 vol.5, e ndodhur në Vrin Dauris, në pronësi të Z.Adrian Sifer Kapllani dti.08.02.1969, rj.Merita Mytazer Kapllani dti.24.06.1970 Në vlerën 8.120.000 (tete milion e njëqind e njëzetë mijë) Lekë.
Ø Pasuria Apartament me sip.120m² nr.pas.417150-1-1 z.k.8518 vol.116 fq.54 me adresë-Plazh 713 Durrës në pronësi të Z.Adrian Sifer Kapllani dti.08.02.1969. Në vlerën 3.767.299 (tre milion e shtatëqind e gjashtëqindë e shtata mijë e dyqind e nentëdhjetë e nëntë) lekë.
Ankand zhvillohet në datën 11.04.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimeve gjyqësore me adresë Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

Shoqëria përbarimorë JUSTITIA
Shoqëria përbarimorë JUSTITIA shpall ankandin, faza e parë, për shitjen e pasurisë së paluajtshme për të cilën ka vënë hipoteke ALPHA BANK, me këto të dhëna:
Ø Apartament me nr.pas.7/21+1-4, z.k.8360, vol.26, fq. 204, me sip. 138.40 m², Rruga "Zenei Baboci" Tiranë, në pronësi të z.Gentian Kujum TOSKU.
Në vlerën 124.008 Euro (njëqind e njëzetë e katër mijë e gjashtëzetë).
Ankand zhvillohet në datën 23.04.2019, në përfundim të orarit zyrtar, ora 16:30 në zyrën e përbarimeve gjyqësore me adresë Bulevardi Bajram Curri, Pall. 21.Shk. 3, Ap. 18, Tiranë.

Njoftim për shitje me ankand të parë
Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k ka shpallur në datë 28.03.2019 ankandin e parë të pasurisë të palës debitore Sh' Meat Master Vilezart Kirca sh.p.k dhe e palës dorezanesë, e përbërë nga:
"Njësi" me numër pasurie 7780 ND e ndodhur në Rr: "M Bickerni" Shkodër e regjistruar në ZK 8593 Regji Hipotekor nr.83 datë 30.10.1988 volum 17, faga 149 me sipërfaqe 42.75 m². Ankand i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 45.517.3 Euro dyzete e pesëmijë e pesëqind e shtatëdhjetë e njëqind (me Euro)
Ankand do të zhvillohet në datë 15.04.2019 ora 15:00 në selinë Bulevardi "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5 Kontakt tel. 0672082543, Iiir_dervishaj@yahoo.com, WEB www.powerjustice-al.com.

Publikohet lista me pronarët që kompensohen për truallin e zënë nga ndërtimet informale

Qeveria ka miratuar kompensimin financiar të pronarëve që preken nga ndërtimet informale. Janë në total 600 pronarë, të cilët do marrin mbi 347 milionë lekë. Përfituesit janë në Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Shëtesat, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Masa e kompensimit është 20 694,8 m² dhe vlera e përgjithshme e kompensimit financiar është 347 349 219 lekë. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të përfituesve së bashku me shumë për çdo pronar. Për kompensimin e pronarëve përdoren po ato të ardhura që arkëtohen Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia e Trajtitimit të Pronës. Pronari plotëson një

Tokat e zëna, 600 pronarë marrin 347 milionë lekë

Përfituesit në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër, Lezhë e Vlorë

kërkesë për kompensimin në vlerë sipas formatit tip, që vihet në dispozicion nga ATP-ja. I interesuari duhet të paraqesë dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të

subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt

noterial të sille certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie. Një tjetër dokument është vërtetimi i lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë

bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar. Qeveria urdhëron Zyrat Vendore e

Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, përkatesisht në Elbasan, Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër, të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme.

LISTA ME PRONARËT QË KOMPENSOHEN

Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²)	Numri i Pronarëve e qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve			Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
		Emër	Atësi	Mbiemër	
	1	HATIXHE	SHAHIN	TOÇLA	653,102.40
	2	SELM	SHAHIN	DERVISHI	
	3	ZADE	SHAHIN	LAMI	
	4	HAVA	SHAHIN	XHEPEXHIU	
	5	LULJETA	SHAHIN	KUMRIA	
	6	HAJRIE		DERVISHI	
	7	ENEIDA	RAMAZA	DERVISHI	
	8	ENXHI	RAMAZA	DERVISHI	
	9	TAIBE	SHAHIN	DERVISHI	
	10	KADRI	SHAHIN	DERVISHI	
	11	ENGJELLU	SHAHIN	DêZHA	
	12	BAJAME	DALIP	DERVISHI	
	13	NEXHME	DALIP	BEQIRI	
	14	AGIM	DALIP	DERVISHI	
	15	FATOS	DALIP	DERVISHI	
	16	FLORA	DALIP	HYSA	
	17	MANUSH		DERVISHI	
	18	SUZANA	HAJDAR	ÇEKREZI	
	19	FATMIR	HAJDAR	DERVISHI	
	20	ANILA	HAJDAR	DERVISHI	
	21	LILJANA	HAJDAR	DERVISHI	
	22	HURMA		DERVISHI	
	23	ZHULJET	MUSA	BALLIU	
	24	ARDJANA		DERVISHI	
	25	KLEJVI	AGRON	DERVISHI	
	26	XHORXHI	AGRON	DERVISHI	
	27	ELIDA	MUSA	DERVISHI	
	28	BRUNILD	MUSA	BAJRAMI	
	29	KLODIAN	MUSA	JAUPI	
	30	BEJAZE	TARE	TATA	
	31	TRANE	OSMAN	DISHA	
	32	PËRPARI	SULEJM	DISHA	
	33	SHOIQE	SULEJM	DISHA	
	34	MAJLINDA	SULEJM	DISHA	
				17,370.60	
	35	LLAMBI	STAVRI	JORDANI	187,630.80
	36	LIVAN		QOSJA	613,948.40
	37	MYZEJEN		KRASNIQI	
	38	FATIME		KRASNIQI	
	39	SKENDE		KRASNIQI	
	40	ISMETE		KRASNIQI	
	41	BEDRIJE		KRASNIQI	
	42	QEMAL		KRASNIQI	
	43	XHEVAHI		KRASNIQI	
	44	IKBAL		QOSJA	
	45	TOMORR		QOSJA	
	46	RASIM		QOSJA	
	47	HAXHIRE		QOSJA	
	48	LUIZA		QOSJA	
	49	ILIRJAN		QOSJA	
	50	AGRON		QOSJA	
				613,948.40	
				2,933,167.20	
				4,130,430.40	
				2,915,297.60	

Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²)	Numri i Pronarëve e qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve			Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
		Emër	Atësi	Mbiemër	
					2,915,297.60
	51	XHELAL	MYRTE ZA	TUPI	2,666,399.60
	52	ALJ	JAKUP	MYSLIHAKA	1,384,894.00
	53	LLAMBI	SIMON	BULI	4,838,832.40
	54	VEZIKO	HEKURA	HASA	
	55	HIDAJETE	VEHBI	GARUNJA	4,196,803.2
	56	DALLANDY	VEHBI	ISUFJAJ	
	57	MIMOZA	VEHBI	HASA	
	58	ELENI	VEHBI	MAVRAQI	
	59	SHOIQE	VEHBI	SELIMAJ	
	60	ENKELEJ	VEHBI	MUSAJ	
	61	NAILE	VEHBI	HASA	
	62	IBRAHIM		TOPTANI	
	63	LILJANA	SHERIF	SHTINO	
	64	ILONA	VASIF	ZISO	
	65	VIVIANA	PETRIT	TOPTANI	
	66	QAMIL	HYSEN	BIÇAKU	
	67	GJINOVEF	MUSTAF	BIÇAKU	
	68	NERAIDA	HYSEN	TAUSHANI	
	69	LUM-MIR	SHERIF	FRASHERI	
	70	RITA	SHERIF	FRASHERI	
	71		MEHMET SEBAUDIN	DERVISH	
	72		AHMET SHYOQRI	DERVISH	
	73	EVELINA	PETRIT	OYQJA	
	74	SEFEDIN	SHYRI	BIÇAKÇIU	
	75	REFIK	PETRIT	TOPTANI	
	76	SAIDE		PAJOVA	
	77	ZYBA		MUSAJ	
	78	FATMIR		BESNIKU(KOPI)	
	79	ENGJELLU	IBRAHIM	SHENGJERGJI	
	80	ZYHRA		GRECA	
	81	MAKBULE		ZENELHOXHA	
	82	HYSEN		VELENICA	
	83	HIQMETE		LABINOTI	
	84	EDISON		VELENICA	
	85	SHEFQET		TUXHARI	
	86	ILIRJANA		STAF	
	87	MARIA		JORGO	
	88	ARTUR		MEZINI	
	89	KRENAR		MEZINI	
	90	SAIDE		PAJOVA	
	91	ZYBA		MUSAJ	
	92	FATMIR		BESNIKU(KOPI)	
	93	ENGJELLU	IBRAHIM	SHENGJERGJI	
	94	ZYHRA		GRECA	
	95	MAKBULE		ZENELHOXHA	
	96	HYSEN		VELENICA	
	97	HIQMETE		LABINOTI	
	98	EDISON		VELENICA	
	99	SHEFQET		TUXHARI	
	100	ILIRJANA		STAF	
	101	MARIA		JORGO	
	102	ARTUR		MEZINI	
				5,334,075.60	
				5,252,386.00	

Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²)	Numri i Pronarëve e qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve			Shuma - Vlera e kompensimit (lek)
		Emër	Atësi	Mbiemër	
	104	SAIDE		PAJOVA	4,221,054.80
	105	ZYBA		MUSAJ	
	106	FATMIR		BESNIKU(KOPI)	
	107	ENGJELLU	IBRAHIM	SHENGJERGJI	
	108	ZYHRA		GRECA	
	109	MAKBULE		ZENELHOXHA	
	110	HYSEN		VELENICA	
	111	HIQMETE		LABINOTI	
	112	EDISON		VELENICA	
	113	SHEFQET		TUXHARI	
	114	ILIRJANA		STAF	
	115	MARIA		JORGO	
	116	ARTUR		MEZINI	
	117	KRENAR		MEZINI	
	118	SAIDE		PAJOVA	
	119	ZYBA		MUSAJ	
	120	FATMIR		BESNIKU(KOPI)	
	121	ENGJELLU	IBRAHIM	SHENGJERGJI	
	122	ZYHRA		GRECA	
	123	MAKBULE		ZENELHOXHA	
	124	HYSEN		VELENICA	
	125	HIQMETE		LABINOTI	
				4,316,784.80	
	126	EDISON		VELENICA	6,202,027.60
	127	SHEFQET		TUXHARI	
	128	ILIRJANA		STAF	
	129	MARIA		JORGO	
	130	ARTUR		MEZINI	
	131	KRENAR		MEZINI	
	132	THEMISTO		BEBI	
				6,202,027.60	
	133	MAKBULE	OAZIM	BALA	13,522,181.60
	134	MUSA	MUSTAF	XHEPA	
	135	ISMET	RIZA	XHEPA	
	136	NURI	RIZA	XHEPA	
	137	ILIRIANA	MUSA	BASHA	
	138	LUAN	SULEJM	STRINGA	
	139	XHEMAL	OAZIM	XHEPA	
	140	REZAR	RIZA	XHEPA	
	141	AIDA	MAUSA	MEÇA	
	142	RAJMONDA	VELI	KASMI	
	143	ZENEPE	OAZIM	ZALLA	
	144	OMER	AZMI	STRINGA	
	145	ARBEN	AGRON	STRINGA	
	146	ERWIN	MUSTAFA	LAMÇJA	
	147	GLADIOLA	AGRON	STRINGA(DAKU)	
	148	LILJANA	MUSTAFA	LAMÇJA(BIÇOKU)	
	149	LUMNIJE	ZIA	LUNIKU(MUÇA)	
	150	MERITA	MUSTAFA	LAMÇJA(DURO)	
	151	PRANVERA	AZMI	HAMZU(STRING)	
	152	VJOLLCA	ZIA	LUNIKU	
	153	BENON	MUSTAFA	LAMÇJA	
	154	BRIKENA	SEZAI	HAXHIADEMI(BA)	
	155	ALEMSHA	AZMI	BOLLANO(STRIN)	
				5,220,476.00	

156	DALIP	KADRI	BAKALLI	1,919,705.60
157	FATUSH		BAKALLI	
158	NASHIFER		BAKALLI	
159	MELEO		BAKALLI	
160	KADESHE		BAKALLI	
161	MUSA		BAKALLI	4,448,254.00
162	SHEJNAZ		BAKALLI	
163	BURBUOE		BAKALLI	
164	DRITAN	SADIK	ÇENGELI	
165	MAHMUD	DALIP	XHANI	3,281,624.40
166	AMARILD	AGRON	ZABELI	
167	KEIDA	AGRON	ZABELI	
168	KLEVIS	AGRON	ZABELI	
169	SHPETIM	NAZMI	SKILJA	
170	TOMOR	YMER	SAMARXHIU	
171	AVNI	YMER	SAMARXHIU	
172	LIVIA	KASTRIO	ZABELI	
173	LEDIO	KASTRIO	ZABELI	
174	KASTRIOT	HYSNI	ZABELI	
175	BUJAR	HYSNI	ZABELI	
176	EGLANTI	HYSNI	ZABELI	
177	SHPRESA	HYSNI	ZABELI	
178	ARJANA	HYSNI	ZABELI	
179	PLATON	HYSNI	ZABELI	
180	ELIDA	HYSNI	ZABELI	5,847,188.4
181	FERDINA	SULEJM	MURATI	
182	HATIXHE	SULEJM	KAFEXHIU	
183	VIOLLCA	SULEJM	DHEFTO	
184	DASHAMIRI	RIZA	LUNIKU	
185	ELISABETA	SURJA	XHIXHA	
186	FLORA	RAMAZAN	BALZA	
187	HYOMET	RIZA	LUNIKU	
188	MILIXHEMI	RIZA	LUNIKU	
189	SHAZME	MUSTAFA	LUNIKU	
190	SURJA	SHERIF	XHIXHA	
191	ERVIN	MUSTAFA	LAMÇJA	
192	LILJANA	MUSTAFA	LAMÇJA(BIÇOKU)	
193	LUMNIJE	ZJA	LUNIKU(MUÇA)	
194	MERITA	MUSTAFA	LAMÇJA(DURO)	
195	VJOLLCA	ZJA	LUNIKU	
196	AHMET	HAJDAR	ISAJ	6,667,785.96
197	LINDITA	SURJA	XHIXHA	
198	ABDURRAHM		LUNIKU	
199	BENON	MUSTAFA	LAMÇJA	
200	SEIT		LUNIKU	
201	SELM		LUNIKU	
202	NEXHATJIE		OAFI	
203	SHAOIR	RIZA	LUNIKU	
204	FERIT	BEHXHET	LUNIKU	
205	SYPHIJE	BEHXHET	DYLGJERI	
206	KUME		LUNIKU	
207	BASHKIM	BEHXHET	LUNIKU	
208	BURBUOE	HAJDAR	SHTRAZA	
209	VJOLLCA	HAJDAR	SELITA	
210	HATIXHE	HAJDAR	BAJRAKTARI	
211	LINDITA	KUJTIM	AGOLLI	
212	BESA	KUJTIM	ISAJ	
213	VALTER	ZEOIR	HOXHA	
214	PRANVERA	ALUSH	BALZA	
215	IKBAL	ALUSH	BALZA	
216	ENGJELLUS	ALUSH	BALZA	
217	FIDIRI	ALUSH	BALZA	
218	ROVENA	AGIM	BALZA	
219	ARLUND	AGIM	BALZA	
220	HILMIJE		KRYPA	
221	FATOS		LUNIKU	
222	LAVDIJE		DOMI	
223	SAMI		LUNIKU	
224	SUZANA	MUSTAFA	LUNIKU	
225	ALFONC	NUREDIN	LUNIKU	
226	AGIM	NUREDIN	LUNIKU	
227	ANI	KUJTIM	HOXHA	
228	MERLIN	NEXHDET	HOXHA	
229	ANILA	KUDRET	HOXHA	
230	AFERDITA	YMER	HASEQIU(HAX)	4,035,976.80
231	AGIM	YMER	HAXHIMUSAJ	
232	ANILA	MUSTAF	KATRO(SHOPI)	
233	BURBUOE		STRUGU	
234	FERDINAN		STRUGU	
235	FLORINDA		FUGA(STRUG)	
236	HATIXHE	MUSTAF	SHOPI(KARKA)	
237	HEDJIE	YMER	HAXHIMUSAJ	
238	LUMTURI		FUGA(STRUG)	
239	MIMOZA	MUSTAF	SHOPI(CEKA)	
240	MIRELA	MUSTAF	SHOPI	
241	MYZEJEN		STRUGU	
242	SANIJE	YMER	BAKALLI(HAXHI)	

243	ADRIAN	DILAVER	SEJDINI	5,143,892.00
244	BEKIM	RIFAT	KADIU	
245	OMER	AZMI	STRINGA	
246	ARBEN	AGRON	STRINGA	
247	ERVIN	MUSTAFA	LAMÇJA	
248	GLADIOLA	AGRON	STRINGA(DAKLI)	
249	LILJANA	MUSTAFA	LAMÇJA(BIÇOKU)	
250	LUMNIJE	ZJA	LUNIKU(MUÇA)	
251	MERITA	MUSTAFA	LAMÇJA(DURO)	
252	PRANVERA	AZMI	HAMZA(STRING)	
253	VJOLLCA	ZJA	LUNIKU	
254	BENON	MUSTAFA	LAMÇJA	
255	BRIKENA	SEZAI	HAXHIADEM(BA)	
256	ALEMSHA	AZMI	BOLLANO(STRIN)	
257	BURBUOE	IBRAHIM	HASEKIU	3,041,661.20
258	NIMETE	IBRAHIM	HASEKIU	
259	MANUSHAQ	RIFAT	BUMÇI	
260	ENGJELLUS	RIFAT	BUMÇI	
261	FATBARDHA	RIFAT	BUMÇI	
262	GAZMEND	PETRIT	HASEKIU	
263	IBRAHIM	PETRIT	HASEKIU	
264	ANDREA	PETRIT	HASEKIU	
265	EDUART	MUSA	DUHANXHI	
266	IRMA	HAJRULL	MURATI	
267	MEHMET	HYSEN	SHUJAKU	
268	MERDIJE	KAMBER	DUHANXHI	
269	SHEFOET	KAMBER	DUHANXHI	
270	SHPRESA	MUSA	DUHANXHI	
271	BURBUOE	HYSEN	XHEPA	
272	OAZIM	MUSA	DUHANXHIU	
273	HYSEN	VELI	GJATA	
274	ISUF	KAMBER	DUHANXHIU	
275	AGRON	TEKI	TELA	3,669,650.00
276	ANITA	MASAR	ALICKA	
277	BULENT	TEKI	TELA	
278	EDMOND	TEKI	TELA	
279	FELATUN	MAZLE	KARAIKAKAJ	
280	GJERAK	MAZLE	KARAIKAKAJ	
281	HAJALI	ISMAL	YPI	
282	LAVDIJE	SKENDE	KALASA	
283	NEBI	ISMAL	SEFA	
284	NESFJIE	TEKI	SELENICA(TEL)	
285	SHAZIVAR	MASAR	KARAOSMANI	
286	SHEGUS	MASAR	KOSOVA	
287	TEUTA	SKENDE	FOR A	
288	XHANETA	ISMAL	PRODANI	
289	HENRIET	KADRI	KUNGULLI	
290	OMER	AZMI	STRINGA	6,343,708.00
291	ARBEN	AGRON	STRINGA	
292	ERVIN	MUSTAF	LAMÇJA	
293	GLADIOLA	AGRON	STRINGA(DAK)	
294	LUMNIJE	ZJA	LUNIKU(MUÇA)	
295	MERITA	MUSTAF	LAMÇJA(DURO)	
296	PRANVER	AZMI	HAMZA(STRIN)	
297	VJOLLCA	ZJA	LUNIKU	
298	LILJANA	MUSTAF	LAMÇJA(BIÇOK)	
299	BENON	MUSTAF	LAMÇJA	
300	BRIKENA	SEZAI	HAXHIADEM(B)	
301	ALEMSHA	AZMI	BOLLANO(STR)	
302	SHOIPONJ	AGRO	KUSI	
303	DANJELA	DURIM	KUSI	
304	GEZIM	DURIM	KUSI	
305	KEJSI	DURIM	KUSI	
306	PULLUMB		QOSIA	270,156.00
307	HAMIDE		RUSHEKU	14,715,993.60
308	NADIRE	MYSLY	KELLEZI	
309	AGIM	EMIN	MUÇA	
310	ILIR	EMIN	MUÇA	
311	LUCIE		DOMA	
312	REXHEP		DOMA	
313	SABRIJE		DOMA	
314		KOMUNITETI MYSLYMAN	5,063,212.00	
315	BUKURIE		KOKONOZI	131,512.00
316	SULEJMAN		KOKONOZI	384,672.60
317	MEHEM		ILJAZI	14,104,662.00
318	SULEJMAN		ILJAZI	
319				
320		KRYEGJYSHATA BOTERORE BEKTASHIANE	9,068,300.00	
321		Y.Y.ALBANIA DEVELOP.LTD	4,274,569.80	

321		Y.Y.ALBANIA DEVELOP.LTD	4,274,569.80	
322	LINDITA		DUSHMANI	10,670,600.40
323	ZHULIETA	BESIM	HARASANI	
324	MUHAMET	ISMAL	SHPATI	
325	ARBEN	BESIM	SINA	
326	OSMAN	HYSEN	KOKOLI	
327	SKENDE	ISMAL	SHPATI	
328	KUJTIM	ISMAL	SHPATI	
329	QEFSERE	ISMAL	ZHEGU	
330	PETRIT	ISMAL	SHPATI	
331	VJOLLCA	ISMAL	DUSHKU	
332	FATMIRE	ISMAL	VATHI	
333	HYSEN	OSMAN	KOKOLI	
334	DURIM	OSMAN	KOKOLI	
335	ALMA	OSMAN	KOKOLI	
336	BRKENA	OSMAN	KOKOLI	
337	HAXHI		DERHEMI	10,630,695.00
338	HASAN		DERHEMI	
339	SANIE		DERHEMI	
340	MAKBULE		DERHEMI	
341	EDLIRA		METANI	
342	LINDITA		BALLA	
343	NAILE		METANI	
344	ZAMIRA		KLEMENDI(DE)	
345	ARJAN		DERHEMI	
346	INDRIT		DERHEMI	
347	EVA		TOCI	
348	KUDRETE		ELBASANI	
349	IRMA		SHEHAJ	
350		MBIVENDOSJE	6,713,687.60	
351		MBIVENDOSJE	1,568,280.60	
352	MALIQ	MAHMUT	TAFI	3,905,906.40
353	ALBANA	SELFO	DEMI	9,756,240.00
354	ARMANDO	SELFO	MOSHO	
355	BARDHYL		MUMAJESI	
356	MAKSIM		MUMAJESI	
357	MUBAREQ		MUMAJESI	
358	BAJRAM		MUMAJESI	
359	NAILE		MUMAJESI	
360	MIRJAN		MUMAJESI	
361	MILUKA		MUMAJESI	
362	EDMOND		MUMAJESI	
363	ELVIJE		VOGLI	
364	BASHKIM		ARBANA	
365	ISLAM		ARBANA	
366		KRYEGJYSHATA BOTERORE	7,442,260.00	
367		KRYEGJYSHATA BOTERORE	12,851,970.00	
368	ALDA		TOPTANI	11,206,660.00
369	ARDIAN		TOPTANI	
370	FADIL		TOPTANI	
371	LUMTURI		TOPTANI	
372	MYNEVERE		TOPTANI	
373	VERA		TOPTANI	
374	XHULI		TOPTANI	
375	REFIK	HAXHI	ABAZI	
376	BARDHYL		ABAZI	
377	FATIME		DEDJA	
378	HATIXHE		BALLA	
379	HAZIZ		ABAZI	
380	KAJE		MUMAJESI	
381	KUMERI		BALLA	
382	MALIQ		ABAZI	
383	MUHARRE		ABAZI	
384	MUSA		ABAZI	
385	OSMAN		ABAZI	
386	RAZIJIE		RAUFI	
387	SHEQER		ABAZI	
388	SHERIFE		ABAZI	
389	VELI		ABAZI	
390	XHARIE		ABAZI	
391	XHEMILE		ABAZI	
392	HAXHIRE		BAKALLI	
393	EDUART	SALI	BEIU	14,104,662.00
394	GANI	ABDULLA	BEIU	
395	MERITA	SALI	BAKIU	
396	RAMAZAN	ABDULLA	BEIU	
397	DIANA	ESAT	CORAJ	
398	ZHAKLIN	ESAT	BEIU	

Profesoresha: Propozimi nga PASOK nuk është i rastësishëm

Eda Gemi, kandidatja shqiptare për në Parlamentin European

Ku mund të votojnë shqiptarët me nënshtetësi greke

Rezarta Delisula

Eda Gemi, afro 30 vjet më parë emigroi si mijëra shqiptarë të tjerë në Greqi. Me dëshirën për të studiuar dhe për t'u integruar në jetën e vendasve, punoi fort deri sa për pak vite u fut në rrugën e të drejtave të njeriut, e emigrantëve në veçanti, dhe sot është në listat e PASOK si kandidatë për Parlamentin European. Ndaj shqiptarët që kanë nënshtetësi greke kudo që ndodhen mund të votojnë për të parën shqiptare që do të kandidojë në Parlamentin European për të qenë të përfaqësuar denjësisht.

Si ju erdhi propozimi për të kandiduar në Parlamentin European?

Po të shohim trajektoren e karrierës sime në Greqi, propozimi nuk është i rastësishëm. Unë kam vite që bashkëpunoj me PASOK jo si anëtare partie, por si eksperte e emigracionit. Që në vitin 2002 kam qenë këshilltare e eurodeputetes së PASOK aso kohe dhe merresha me emigracionin, të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut në tërësi. Në vitin 2009-2010 isha anëtare e komisionit të kryeministrit Jorgo Papandreu, për politikën migratore. Ne ishim grupi i parë që u morëm me formulimin e reformës dhe ligjit për marrjen e nënshtetësisë greke, ku për herë të parë, në 2010, ligji u njohu të drejtën e aksesit për nënshtetësinë greke të brezit të dytë të emigrantëve dhe brezit të parë e drejta për të marrë pjesë në votime lokale, pavarësisht shtetësisë.

Pra, një pjesë e meritës për ligjin e nënshtetësisë greke ju atribuohet ju?

Nuk do të thosha meritë e imja, por e bashkëpunimit shumëvjeçar me këtë parti politike për çështjet e emigracionit.

Rikthemi dhe një herë te momenti i propozimit, kur erdhi?

Kontakti i parë ka qenë në nëntor, ndërkohë që po bëheshin negociatat përkatëse për të zgjedhur listat për europarlament. PASOK ka qenë dhe është parti shumë e hapur megjithëse ka kaluar një fazë të vështirë pas krizës ekonomike dhe rënies së mbështetjes popullore që ka pasur në fund të viteve 2000. Propozimi më erdhi nga këshilltari i kryetares aktuale të PASOK Fofi Genimata. Fillim negociatave e vendosa të kandidoj, sepse ishte momenti duhur, moment historik, pasi, për herë të parë nga 2011-2018, kemi një masivizim të aksesit të sh-



qiptarëve të nënshtetësisë. Kemi 230 mijë shqiptarë që kanë marrë nënshtetësinë dhe janë të barabartë nga pikëpamja institucionale. Dhe është hera e parë po historike pas 30 vjet emigracioni që shqiptarët mund të kenë përfaqësuesin e tyre në parlamentin europian.

Sa europarlamentarë ka Greqia në Parlamentin European?

21 vende ka në Parlament. **Sa vota ju duhen për të qenë deputete?**

PASOK është parti në rritje pas krizës që pësoi pas krizës ekonomike, ndryshimit të hartës politike ku Agimi Artë mori revansh dhe krizës së refugjatëve. PASOK nuk është parti që i sheh emigrantët si qytetarë të dorës së dytë, por si deponizt kryesore e ripërtërithjes së elektoratit që do votojë për PASOK, por dhe përfaqësueses së këtij elektorati.

Për herë të parë është një shqiptare kandidatë për Parlament European?

Po, për herë të parë një shqiptare del në listat zyrtare për Euro Parlament.

Ku mund të votojnë shqiptarët dhe cilët kanë të drejtë vote?

Të drejtë votimi kanë të gjithë shqiptarët që kanë nënshtetësi greke, qoftë të brezit të parë, qoftë të brezit të dytë dhe ata që ndodhen jashtë Greqisë, në Londër, Bruksel, Berlin... Ata duhet të regjistrohen deri më datë 5 prill në linkun e mposhtëm, dhe votimi bëhet në konsullatat greke të vendeve ku

ata jetojnë.

[http://www.ypes.gr/epe2019/\(S\(33d3ni45zs2kgfv2htpzdoymf\)\)/search_me_18.aspx?fbclid=IwAR2YBUQIGY-Yfbq5CwAjjS6kVVU-9W9U52D6VdkJP0ctkOOS-DvZHKdLaswU](http://www.ypes.gr/epe2019/(S(33d3ni45zs2kgfv2htpzdoymf))/search_me_18.aspx?fbclid=IwAR2YBUQIGY-Yfbq5CwAjjS6kVVU-9W9U52D6VdkJP0ctkOOS-DvZHKdLaswU)

Si do i mbrosh interesat e votuesve të tu?

E para është përfaqësimi, që të funksionojë një sistem demokratik duhet të jesh i



Eda Gemi në Samitin e Diasporës

Unë kam vite që bashkëpunoj me PASOK jo si anëtare partie, por si eksperte e emigracionit. Që në vitin 2002 kam qenë këshilltare e eurodeputetes së PASOK aso kohe dhe merresha me emigracionin, të drejtat e grave dhe të drejtat e njeriut në tërësi.

përfaqësuar. Janë temat që kanë të bëjnë me emigracionin dhe të drejtat e emigrantëve, e ky është dhe profesioni im. Politikët e mëdha që u japin të drejtë sh-

qiptarëve të quhen high politics që rregullojnë jo vetëm të drejtat e emigrantëve në një vend të caktuar, por dhe modalitetin e tyre në të gjithë Europën si

qytetarë europian.

Si ndjehesh përballë të genit kandidatë për një superparlament?

E privilegjuar dhe me një përgjegjësi të jashtëzakonshme. Kjo është një sfidë e re në jetën time dhe reagimi entuziast i shqiptarëve e ka rritur maksimalisht përgjegjësinë. Në këtë kontekst dua të falënderoj dhe ambasadorin shqiptar në Athinë, një grua jashtëzakonisht profesioniste dhe korrekte, e cila më ofroi mbështetje në këtë sfidë të re timen.

KUSH ESHTË EDA GEMI...

Eda Gemi, (Doctor of Philosophy) është lektore e parë në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënies Ndërkombëtare të Universitetit European të Tiranës, si dhe pedagoge e jashtme në Universitetin e Arteve të Tiranës.

Dr. Gemi është Visiting Research Fellow pranë ISR - Institute for Urban and Regional Research të Akademisë së Shkencave të Austrisë në Vjenë. Pozicioni është akorduar nga Akademia e Shkencave të Austrisë në kuadrin e JESH - Joint Excellence in Science and Humanities.

Që nga viti 2010 ajo mban postin e research fellow pranë Robert



Eda Gemi kandidatë e PASOK për Parlamentin European

Schuman Centre for Advanced Studies e European University Institute (EUI) në Firence, Itali ku ajo është përfshirë në projekte kërkimore të fokusuara në kthimin dhe migracionin ciklik, në rolin i mediave dhe diversitetin kulturor si dhe transnacionalizmin.

Dr. Gemi është e kontraktuar nga Komisioni European si Expert Evaluator për projekte kërkimore: HORIZON 2020, MSCA-IF-2018 and AMIF. Ajo është, gjithashtu, eksperte pranë OECD Network of International Migration Experts. Ajo mban titullin Doctor

of Philosophy nga Faculty of Business and Law i London Metropolitan University, Mbretëria e Bashkuar. Ajo ka fituar titullin Master of Arts në Studimet e Europës Juglindore nga Fakulteti i Shkencave Politike dhe Administratës Publike të Universitetit të Athinës.

Dr. Gemi ka botuar dy monografi si dhe artikuj në revista shkencore të referuara, në vëllime dhe në media. Libri i saj i tretë me titull "Exploring integration and transnationalism in a cross-local perspective: Albanian migrants in Athens and Vienna" pritet të botohet në Maj 2019 nga Akademia e Shkencave të Austrisë.

Dekani i Ekonomikut, Mateo Spaho: Vlerësojmë kontributin ndërkombëtar nga profesori

Voltiza Duro

Eksperti amerikan, leksion në "Luarasi": Strategjite për një biznes të suksesshëm

Terry Trayvick: "Mënyrat për të rritur fitimet e një biznesi"

Në kushtet e një mjedis të ndryshueshëm me konkurrencë intensive, suksesi i biznesit shumë herë mund të jetë i rrisur. Por, strategjitë e duhura të qëndrueshme afatgjata si dhe stafi profesionist mund të luajnë një rol të rëndësishëm në të ardhmen e një biznesi. Për të njohur më mirë planet dhe investimet që duhen ndërmarrë, studentët e Ekonomikut në universitetin "Luarasi" kanë patur mundësinë të ndjekin leksionin e hapur nga Terry Trayvick, strateg i njohur i biznesit me një eksperiencë 30-vjeçare në treg. Dekani i Ekonomikut, Mateo Spaho prezantoi profesorin para studentëve duke vlerësuar kontributin e tij si një konsulent ndërkombëtar i kompanive. Eksperti amerikan i ka shpjeguar studentëve mënyrat e bërjes së biznesit dhe rritjen e fitimit. Mbi të gjitha Trayvick u mësoi të rinjve disa nga strategjitë e rimëkëmbjes së një biznesi pas falimentimit. "Ka shumë mënyra për të fituar 1 milionë dollarë, por çelësi si drejtues është që të jesh i qartë në skuadrën tënde se si do ia dalësh për



Studentët e "Luarasi" gjatë leksionit të hapur me Terry Trayvick



të qenë i suksesshëm. Pasi bëmë kërkimet tona, aritëm në përfundimin që për të dalë fitimtar duhen ndjekur strategji të qëndrueshme. Së pari, si do ta rrisni biznesin, së dyti, si do

ta bëni eficient dhe së treti, duhet të gjeni mënyra për të bërë dallimin nga konkurrentët tuaj", tha strategu. Njëpërmyet praktikave të leksioneve të hapura nga ekspertët më të mirë, studentët

e "Luarasi" mund të ndjekin histori suksesi e të bazohen në modele pozitive për të ardhmen e tyre profesionale. **PROFESORI AMERIKAN** Terry Trayvick është një

strateg i biznesit dhe udhëheqës i transformimit, me mbi 30 vjet eksperiencë në fushën e automobilave, mallrave të konsumit, strehimit, kujdesit shëndetësor dhe industrive ushqimore.

Ai ka fituar respektin e liderëve globalë për aftësinë e tij për të lidhur organizatat e për të dhënë rezultate të jashtëzakonshme në biznes. Njëkohësisht, është themelues dhe CEO i Nivelit të Pestë e si i tillë, ka ndihmuar shumë kompani të zhvillojnë strategjitë fituese dhe planet e ekzekutimit. Arritjet e rëndësishme përfshijnë punën që ndihmoi një ndërtesë të shtëpive në Teksas të rritë të ardhurat 28-fish nga 8 milionë dollarë në 2008 në mbi 200 milionë dollarë në vitin 2018. Një tjetër arritje e dukshme është puna e Nivelit të Pestë që ndihmoi një kompani përbërëse të ushqimit të transformojë performancën vjetore të fitimit nga një histori historike prej 3% (15% rritje vjetore) për një periudhë pesëvjeçare.

Përplasja e pedagogut me Arbër Maznikun: M'u thaftë dora që të votova

"Bujqësori" konflikt me Bashkinë e Tiranës, fidanishtja e praktikave kthehet në shkollë

Rektori: Nuk kemi dijeni, jemi në gjyq me pronarët

Mëngjesin e ditës së djeshme, studentët e pedagogë të Universitetit Bujqësor të Tiranës kanë protestuar kundër ndërtimit të një shkolle të re në pjesën e fidanishtes ku ata bëjnë praktikën. Sipas rektorit të UBT-së, Bahri Musabeliu kjo pjesë e tokës, ka qenë pronë private, por e ka blerë Bashkia e Tiranës me synim ndërtimin e një shkolle 9-vjeçare. Më tej ai sqaroi se ka qenë vetë kryeministri që i ka premtuar universitetit modernizimin e fidanishtes në këtë tokë.

"Kryeministri na pati premtuar neve se do t'i blejë këto prona që iu kishte dalë pronari dhe do na i kalonte neve që ta modernizonim fidanishten, por tani mësojmë

që ia ka kaluar Bashkisë së Tiranës. Ajo që më shqetëson është që ky është një kampus që iu dedikohet studentëve. Unë personalisht nuk jam kundër shkollës, por ka vende të tjera ku mund të ndërtohet. Si rektor nuk kam patur asnjë dijeni për ndërtimin e kësaj shkolle, kjo është tamam si rrufe në qiell të pastër," - theksoi rektori. Musabeliu shtoi se në këtë plan prej 25 ha, përfshihet Kampusi i Universitetit dhe dy sipërfaqe toke, të ndara nga një rrugë pedonale për të mundësuar akses për studentët, dhe parcelat e tokës janë pronë private, por prej 3 vitesh universiteti i pronarët janë në gjyq.

PËRPLASJA


Konflikti i djeshëm është shoqëruar edhe me përplasje mes pedagogëve dhe nënkryetarit të Bashkisë. Arbër Mazniku, teksa po



Konflikti i djeshëm mes pedagogëve dhe nënkryetarit të Bashkisë. Arbër Mazniku

jepte një prononcim për mediat, është ndërprerë nga pedagogu i vreshtarisë Lush Susaj, i cili e ka akuzuar atë se po shkatërron universitetin. "70 breza kemi nxjerrë këtu. Jam vetë pronar tokash, që ma ka zënë HEC dhe nuk pretendoj kurrë të shkul hidro-


centralin. Kam qenë student e jam pedagog në këtë universitet. Kjo është qendër didaktike, bënim praktika e teori. Ja ku keni vend për të ndërtuar 10 shkollë sipër veterinarisë. Ju po prekeni dhe keni shkatërruar universitetin dhe unë nuk flas për interesat e mia. Unë



REAGIMI

"Unë mbroj interesin e studentëve, të kishit ardhur për bisedime me ne. Ne kemi duartrokatur masterplanin e kryeministrit. Ju kam votuar, ma thaftë Zoti dorën! Po të dëgjoj për respekt si nënkryetar bashkie, ndryshe s' të dëgjoj asnjë sekond", -tha ndër të tjera pedagogu.

Pedagogu



"RRUFE NË QIELL TË HAPUR"

"Ajo që më shqetëson është që ky është një kampus që iu dedikohet studentëve. Unë personalisht nuk jam kundër shkollës, por ka vende të tjera ku mund të ndërtohet. Si rektor nuk kam patur asnjë dijeni për ndërtimin e kësaj shkolle, kjo është tamam si rrufe në qiell të pastër," -theksoi rektori.

Rektori

mbroj interesin e studentëve, të kishit ardhur për bisedime me ne. Ne kemi duartrokatur masterplanin e kryeministrit. Ju kam votuar, ma thaftë Zoti dorën! Po të dëgjoj për respekt si nënkryetar bashkie, ndryshe s' të dëgjoj asnjë sekond", -tha ndër të tjera pedagogu. Ndërkohë

nënkryetari i Bashkisë Arbër Mazniku është shprehur i vendosur në ndërtimin e shkollës 9-vjeçare në zonën e projektuar. Sipas Maznikut shkollla do i shërbejë fëmijëve të zonës përreth banorët e së cilës kanë të drejta dhe meritojnë të ketë një shkollë.

LIBRI

ANISSA MARKARIAN

Aktorja kthehet para publikut me një roman

Aktorja e njohur Anissa Markarian do të rikthehet para publikut shqiptar. Por jo në skenë. Është një roman që merr shkas po nga Shqipëria dhe kohët kur ajo jetonte ende këtu. Ka prezantuar të parin, një prej personazheve, bazuar te një djalë që ka njohur kur ishte studente. "Kur isha studente në Mjekësi, gjatë muajit të praktikës në shërbimin e ortopedisë, të udhëhequr nga prof. Panajot Boga, pata njohur një pacient 21-vjeçar me këmbën e djathtë të cunguar gjer në gju. Një histori sa e dhimbshme, aq edhe e përveçme, që mu ngulit në mendje e më frymëzoi një nga personazhet më të dashur të romanit tim të ri, "15 ditë prilli", thotë Markarian. Ajo ka zgjedhur ta prezantojë romanin nisur nga Teo. Romani "15 ditë prilli" po përgatitet për botim nga shtëpia botuese "Çabej". Anissa lindi në Tiranë, në vitin 1962, vajza e Agop Markarian, një dentist shqiptar me origjinë armene dhe një shqiptareje nga Tirana. Me profesion mjeke, Anisa u bë edhe aktore dhe skenariste. Ka interpretuar në disa filma, ku ka fituar edhe çmime kombëtare si aktore. Filmin e parë, "Vajzat me kordele të kuqe" e luajti në moshën 16 vjeçe. Ka botuar poezi, tregime e novela dhe librin "Sënduku i kujtimeve" (1997). Jeton dhe punon në Francë që prej vitit 1991, si mjeke nutricioniste. Ka dy fëmije, një vajze e një djalë. Filma të tjerë ku ka luajtur: "Në çdo stinë" - (1980), nderuar me kupën e Festivalit të 4-ët të Filmit si aktorja më e mirë në rol kryesor; "Pranvera s'erdhi vetëm" (1988) bashkëskenariste dhe interpretese e rolit kryesor. Ky film fitoi kupën e Festivalit të 8-të; "Ngjyrat e moshës" (1990) skenariste dhe interpretese e rolit kryesor etj..

PJESË NGA LIBRI

Dita e tretë
E mërkurë, 10 prill

- A u mësove me patericë? - Iu drejtua mjeku specializant, pacientit të shtrirë në divanin e ekzaminimit, një djalosh 21-vjeçar me emrin Teo.

- S'bëj dot më shumë se 40-50 metra, se më therin rrezat e krahëve. Plagë i kam sjetullat, - u ankua ai, i ngërdheshur në fytyrë nga përjetimi i dhimbjes.

- Me siguri, i mëshon trupit më shumë se ç'duhet. I gjendet dermani, mos u bëj merak. Duhet lidhur dy jastëkë të vegjël mbi tërthorëset e patericave që të zbutet fërkimi me lëkurën. T'i sajoni ndihmësinfermieri kur të shkosh në pavijon, - e qetësoi mjeku.

Nën bluzën e bardhë kishte veshur uniformën e oficerit rezervist - specializimin në ortopedi e kryente në Spitalin Madhor të Forcave të Armatosura. Qëndronte përballë kornizës me ndriçim qumështor, që shërbente për të lexuar radiografitë. Mbi xhamin e saj ishin rradhitur 4 filma të sapozh-villuar. Paraqitnin, balltas e në profil, shtratit e legenit të të kërdhokullit dhe kupën e gjurit të djathtë të Teos. Ishte kontrolli i tretë radiologjik pas operacionit. Specializanti dukej i kënaqur:

- Kur do të ma vini protezën, doktor?



- Hëpërhë është e pamundur. Cungu i gjurit vazhdon të kullojë, - i shpjegoi djaloshiit duke trokitur mbi njerin nga filmat me majën e stiloapsit.

I sëmuri ndodhej në spital që prej tre muajsh. Përfaqësonte një nga ato rastet e dëshpëruara, për të cilët mjekësia kërkon ndihmën e një ndërhyrjeje hyjnore, ngaqë e vetme nuk ia del dot. Shërimi i tij mund të quhej me plot gojë një mrekulli. Por të sëmurit aq i bënte. Në vend që t'i puthte dorën Zotit, përpiqej me të gjitha forcat ta zemëronte. Voziste në një batak mëkati pa as më të voglin teklif.

- Do të zgjasësh shumë kjo gjendje? - u interesua të dinte Teo.

- E vështirë të parashikohet. Disa javë? ... Disa muaj?

- Joo...?!

- Durim! Më e rënda u krye. Nesër do të të transferojmë në "Kosheren e Heronjve".

- Erdhi përgjigja, më në fund? - u gjallërua djalë.

- Po. Falë mbështetjes së Komisionit Mjeko-Ligjor. Pasi e studioi imtësisht rastin tënd, profesor Torrez pranon të të marrë në mjekim. Nuk i bëhet kujtdo ky privilegj, Teo, ta dish!

- Ouu?!

- S'ta merr mendja se ç'do të thotë të jesh bujtës i "Kosheres". ...Njëllaj si të të ishin hapur Portat e Parajsës.

- Ideja ime mbi Parajsën është paksa e veçantë, doktor, - nënqeshi Teo. - Më mirë të mos e dini.

- E di, e di! - ia ktheu specializanti. - Më kanë ardhur në vesh bëmat e tua, - dhe ktheu kokën nga dritarja për t'i dhënë të kupontje që e njihte edhe vendin ku i kryente zullumat.

- Secili ka Parajsën e vet... - u shfaqësua Teo duke ngritur supet.

"15 ditë prilli" do të botohet nga "Çabej", historia e një djalë që njohu kur ishte studente

Dritarja e vetme e zyrës së mjekut shihte nga dushkaja shekullore e mbjellë me bungëbuta, shpardhe e valanidha. Një pyllishtë më se e rëndomtë në dukje, sidomos po ta gjykoje nga qetësia që mbretëronte gjatë ditës. Por, natën ishte tjetër hesap. Me të përëndur dielli, shndërrohej në një fjetore qejfi në qiell të hapur. Çiftohej kush të mundte! Të divorcuarit rishtas, vejshat dhe vejanët, dashnorët e pashpal-

lur, nimfat e panginjura, burrat e pakënaqur... Bënin seks në pozicionet më të pagjashme, të frymëzuar nga shembulli i profesionisteve me tarifa gjakprirëse. Një çetë arrixheshkash si hyri xheneti që e ushtronin zanatin me bindje e kompetencë. Arrinin të zbrurin vendin më të gungët të trupit të klientit në vetëm një çerek ore (tarifa bazë). Sfidonin edhe patrolat e "Ruajtësve të Dëlirësisë Morale", që s'linin vrimë pa gërmuar

Po t'i kapnin "me faktin në dorë", rrezikonin 10 vjet burg për bamirësi të ndaluar. Por nuk u bënte syri tërrë amazonave të dushkajës! Sidomos, qëkurse u kishte dalë nami që zotëronin edhe dhunti hyjnore. Të zhgënjyer nga mjekimet konvencionale, shumë nga të sëmuret e Spitalit Madhor gjenin lehtësim veç në krahëkoshët e tyre. Vizitat tek xherahet zeshkane kryeshin gjithnjë pas mesnatës. (Përdornin melheme e teknika hënore).

Me t'u dhënë sinjali, ndihmësinfermierët transportonin pacientët nga shtrati i lëngimit në zemër të pyllishtës. Kë shtrirë në barelë, kë kruspulluar në karrigen me rrota. Ua linin arrixheshkave në dorë gjysmë të vdekur e, kur shkonin t'i merrnin, i gjenin të esëlluar. Me të njëjtat metoda kishin shëruar edhe Teon. Veçse, për të, ishin nevojitur ndërhyrje grupore të përnatshme. I sëmuri u tregonte muskulin e ngurtësuar (gjithnjë i njëjti) dhe ato përvishnin lërret e i futeshin punës. E fërkonin, e lëpinin, e vajosnin, e thëthinin, por ai veç ankoihej. Dhe ato rifillonin, ia bënin adetet një për një. E kolovitinin, e troshitnin, e ndrydhnin, e shkrydhnin, por ngërçin nuk i kalonte. Atëherë ndërhynte Kleopatra, matka e profesionisteve të qejfit. E pickonte, e thumbonte, e fshikullonte, e asfikullonte... dhe airingallej gjetih! Mjekët nuk kishin të drejtë ta qortonin. E kishin ndjellë vetë, me lutjet e tyre, ndërhyrjen hyjnore...

MBLIDHEN ARKIVISTËT E SHQIPËRISË, TË KOSOVËS DHE MAQEDONISË



dhe demografike, kanë kaluar përidhna të ndryshme konfliktesh të armatosura, kurse fillimi i shek. XXI i gjeti duke aspiruar për anëtarësimin në Bashkimin Europian. Ndryshimet e çfarëdolloshme kanë reflektuar realitetin e tyre në arkiva jo vetëm përmes dokumenteve të prodhuara dhe të arkivuara, por edhe përmes impaktit në ligjet apo rregulloret për-

katëse për arkivat, metodat e punës arkivore dhe në mënyrat e shfrytëzimit; misioni i thelbësor i arkivave ka ndryshuar në varësi të sistemit qeverisës. Temat që propozohen për diskutim janë: Ndërkulturalizmi në Ballkan, të drejtat e njeriut, arkivat nën regjimet represive, trafiku ilegal i trashëgimisë dokumentare, Arkivat dhe krijimtaria artistike, arkivat, përgjegjësia, aksesit në të dhënat dhe mbrojtja e të dhënave personale; arkivat, mjedisi natyror dhe katastrofat mjedisore; bashkëpunimi rajonal në fushën e arkivave dhe trashëgimisë kulturore arkivore; të drejtat e autorit dhe pasuria intelektuale dhe sistemet informatike dhe ruajtja digjitale. Abstraktet pranohen deri më datë 12 maj 2019 në gjuhët e Europës Perëndimore, shqip dhe maqedonisht.



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 655

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Pamela Aliaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 6 Prill 2019

ILIRA GASHI:

RRËFEHET YLLI I RI I POPIT. "BASHKËPUNIMI I ARDHSHEM? DO TË PYES BRITNEY SPEARS"



RRËFEHET ISH-MISI SHQIPTAR

ZHANETA BYBERI: JU RRËFEJ DASHURINË TIME TË PARË, NDJESINË E TË QENIT 'PERENDI'



"Individualiteti do t'ju veçojë gjithmonë dhe do t'ju prijë drejt suksesit"

NGA AURORA TE WILLIAM ZENELI

Artistët shqiptarë që pritet të pushtojnë mbarë botën



Rrëfhet ish-misi shqiptar: Frymëzimi im është të jem në rrugëtim të palodhur të njohjes së vetes sime

ZHANETA BYBERI:

Ju rrëfej dashurinë time të parë, ndjesinë e të qenit 'perëndi'

"Individualiteti do t'ju veçojë gjithmonë dhe do t'ju prijë drejt suksesit"

Pamela Aliaj

Jeta është e mbushur me të papritura dhe çdo moment i jetuar i jep asaj ngjyra të shumta. Është mirë që në gjithë harkun kohor të ekzistencës sonë të kemi mundësi që në fund të saj të kemi arritur të njohim vetveten. Rrugëtimi i saj nisi shumë herët, por në Shqipëri, për herë të parë u evidentua si misi që rrëmbëu kurorën në "Mis Universe Albania" në 2014-ën. Dhe natyrisht që një fitore e tillë e konkursit të bukurisë, vajzës nga Tropoja i hapi shumë dyer. Ndërkaq që rrugëtimi vazhdon me më tepër mundësi të shfaqura e më shumë eksperiencë të jetuara. Në një intervistë ekskluzive për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Zhaneta Byberi vjen në një rrëfim unik dhe tepër frymëzues. Si nisi rrugëtimi i saj si modele, vështirësitë që hasi në jetë dhe projektet e reja që do të sjellë në jetë. Përveçse modele ajo ka edhe talente të tjera lidhur me kinematografinë të cilën e ka patur dashuruar që në vegjëli. Gjithashtu Zhaneta na tregon edhe planet për marrëdhënien e saj me drejtorin e Talleli Production, Blertin pasi së fundmi janë fejuar. Për më tepër në intervistën e mëposhtme:

Jeni një nga bukuroshet shqiptare që rrëmbëu kurorën në 2014. Sa rrugë i janë hapur Zhanetës që nga ajo kohë?

Shumë. Sigurisht që ka patur mundësi që personalisht i konsideroja të favorshme ose jo, por shumëllojshmëri mundësish me perspektivë dolën, siç mund të pritej pas një ngjarjeje të tillë. Sa kam dashur të 'përshtokoj' prej atyre rrugëve, ka qenë rezultat vetëm i zgjedhjeve të mia personale, me pak ndikim mbas të kushteve/ rrethanave të ndryshme që ishin prezente asokohe.

Cila ka qenë eksperiencën në fushën e modës që ju ka lënë më tepër mbresa?

Ka shumë të tilla; përgjithësisht fusha e modës fal emocion të pakrahaseshëm me ndonjë fushë tjetër për një femër që adhuron të shfaq potencialin e saj të plotë të personalitetit dhe jo vetëm, me anë të modës, fotografisë, ecjes etj. Personalisht, çdo eksperiencë, e çfarëdolloj fushe preferoj dhe përipiqem të mos e harroj apo t'ia minimizoj vlerat. Kështu kam arritur të kuptoj se mund të vlerësoj vërtet mësimet e jetës së bashku me bukuritë e saj.



Si ka qenë bashkëpunimi me Fadil Berishën? Për çfarë ju ka ndihmuar njohja me të?

Mund të them që bashkëpunimi me z. Fadil Berisha është ndër më të bukurit që mund të kem patur ndonjëherë. Ai më njohu me botën e kopertinave, bukuritë e fotografisë, kuptimin magjepsës të shprehisë së karakterit përpara një aparati fotografik. Është vërtet kënaqësi të njohësh dhe të punosh me një individ aq pozitiv, i cili të influencon të nxjerrësh në pah versionin më të bukur tëndin në çdo çast të një pune që përgjithësisht cilësohet me të drejtë si stresuese, krahas të qenit argëtues. Por Fadil Berisha ishte një njeri përgjithësisht i qetë dhe pozitiv siç cilësova pak më parë, dhe pa dyshim një fotograf vërtet i zoti. Ishte vërtet

kënaqësi të punoja me të!

Jeni me origjinë nga Tropoja por s'jeni residente në Shqipëri. Cili është vendi prefekt për të jetuar për një modele për të zhvilluar karrierën e saj?

Besoj dhe kam përshtypjen se nuk do jetë aspak çudi për shumë që vendi i përkryer për të nisur/zhvilluar një karrierë në botën e modës, qoftë si modele por jo vetëm, duhet të jetë ShBA. Kjo për arsye të panumërta, ku ndër to mund të cilesoj zhvillimin e tejskajshëm që ka vetë fusha e modës në atë vend në aspekt historik dhe kulturor, si dhe në profesionalizmin që mundësojnë agjensitë e shumta, të themeluara prej vitësh nga individë të cilët kanë lënë gjurmë në fushën e modës, për çdo djalë apo vajzë të


talentuar me dëshirën për të nisur karrierën nga e para ose me synimin për ta zhvilluar më tej në rang profesional.

Përveçse modele keni pasione të tjera lidhur me regjistrën dhe film-in. Keni përfunduar studimet lidhur me këtë fushë?

Mendoj se do më nevojiteshin shumë më tepër intervista për të përmendur vetëm një fraksion të vogël të pasioneve që kam (qesh). Studimet i kam përfunduar lidhur me një fushë paksa më "të thelluar", atë të psikologjisë, por që do thoj se aplikohet lehtësisht në thuajse çdo fushë tjetër të jetës. Kinematografia ka qenë një 'dashuri' e imja që në moshë të vogël. Kinematografinë gjithnjë e kam cilësuar si një botë totalisht më vete. Një fushë në të cilën të jepet mundësi e "rikrijimit", e "të shkruarit të fatit tënd" ose të kujtudo personazh që krijon. Me pak fjalë, është ndjesia e të qenit perëndi, jo në aspektin e superioritetit absolut (qesh) por të jepet një mundësi për të përcjellë copëza të qenies tënde, të personalitetit dhe kreativitetit tënd në çdo fjalë, lëvizje apo shikim që interpreton në atë çast, dhe mund të them që jam fanat e të dashurit ndjesinë që me fal kjo punë. Është vërtet e bukur dhe ndihem shumë e lumtur që më është prezantuar kjo botë. Në fillim ishte thjeshtë argëtuese siç mund ta perceptojë audiencën e gjerë jo-fanatike, por tani është kaq e magjishme në çdo aspekt për mua.

Së fundmi keni bërë një bashkëpunim me këngëtarin Young Zerka dhe Keeptan. Si lindi ideja e këtij projekti?

Çdo projekt ka një ideim bazë, që shpesh hidhet poshtë dhe nuk 'rikthehet në jetë' pas disa draftesh që pasojnë. Por në këtë rast, ide bazë sa i përket këngës së Young Zerka & Keeptan ngeli ashtu siç ishte strukturuar prej fillimit, dhe ishte siç e cilëson vetë titulli 'Smile', ku do flitej për ndjenjën euforike që do u falte dy individëve të veçantë një vajzë, e cila fatkeqsisht nuk do mund të përbalonte çdo gjë që mund të pasonte atë "flirt" të fillimit. Pra me një fjalë, pamundësinë për të dashuruar. Dhe elementet që zgjodha për të theksuar idenë ishin ndryshimi i pamjes dhe tematikës, me anë të përdorimit të parukeve të ndryshme dhe theksimit të rolit të secilit personazh: protagonista ka dashur të lërë pas jetën e mëparshme (atë të një Shoë Girl), në të cilën njihet me personazhin e parë, ku në këtë rast prezantohet Keeptan (fotograf, admirues i saj). Për të vazhduar një jetë paksa më të qetë si një artiste e lirë, ku njihet me personazhin e dytë, Young Zerka (fanatik arti). Çdo gjë përfundon me një 'dhuratë' të cilën ajo



ua lë të dyve: fotografitë e setit-personazhit të parë, dhe portretin-personazhit të dytë. Dhe përfundimi i përmbledhur me vetë titullin është: "Më vjen keq, u përpoqa. Ju kërkoj falje që po largohem, dhe faljen po jua kërkoj me anë të një: buzëqeshjeje"

Keni të tjera projekte në fazë zhvillimi apo që do t'i nisë së shpejti? Për çfarë bëhet fjalë konkretisht?

Kemi goxha surpriza, ku disa kanë filluar tashmë të zhvillohen, dhe shumë të tjera janë ende në pritje për strukturim, planifikim. Konkretisht, kemi disa 'modele' skenarësh që po mendojmë t'i realizojmë së shpejti, prej të cilave disa do të jenë filma artistikë me metrazh të shkurtër në zhanre të ndryshëm, ende të papërcaktuar konkretisht, dhe të tjera do përfshijnë projekte muzikore, promovime veshjesh, aksesorësh, ambientesh të ndryshëm biznesi etj.

Sa e vështirë është të jesh modele apo fotomodelë ditët e sotme dhe çfarë duhet bërë për të dalluar nga të tjerat?

Mendoj se shpeshherë shumë vajza apo djem të rinj, të apasionuar pas kësaj fushe, keqinterpretojnë atë që duhet të japësh apo atë çfarë duhet të jesh për t'u veçuar nga të tjerët, kur në fakt përgjigja ka qenë dhe do jetë gjithnjë po e njëjta: j vetvetjal! Elementi që për mendimin tim është vërtet i papërsëritshëm dhe unik, i cili bën diferencën e vërtetë është identiteti yt. Ajo që të bën ty të jesh...Ti. Më vjen keq kur shoh individë influencial të cilët në vend që të predikojnë për këdo dashurinë për vetveten, të paraqesin përpara adhuruesve bukuri e cila nuk karakterizohet nga elemente sipërfaqësore të flitkuara nga media, lejojnë të rëndojë pesha e vlerësimit vetjak te numri i ndjekësve në rrjetet sociale, lokacionet luksoze në të cilat fotografohen apo sasia e ndërhyrjeve që më pas u instalohen në mendje adhuruesve si "të nevojshme" për t'u

bërë thjesht sepse po shohin "arritjen sociale" te ndikuesit, dhe pas atij çasti, si bëhet synimi i tyre: përgjithësimi medioker i një platforme narciste, që u duket gjithnjë e më tërheqëse, nga ku fillojnë mendojnë me vete "po nëse këtë pëlqen shumica, dua dhe unë të bëhem pjesë e këtij përkufizimit të bukurisë moderne!". Thelbi që doja të cilësoja ishte që duhet mësuar të vlerësohet individualiteti. Nuk mund të lejohet të humbasë as kuptimi i të qenit me plotkuptim pjesë e botës së modës, gjë e cila nuk mund të zëvendësohet kursesi thjesht me një person i

në çdo aspekt të jetës. Cili është pasioni i Zhanetës përveç modelingut dhe filmografisë? Ku e shihni veten në të ardhmen?

Kjo është një pyetje së cilës fatkeqsisht mund t'i përgjigjem vetëm me supozime (qesh). Praktika ime e të jetuarit më lejon të jem fleksibël në dëshirat, kërkesat apo synimet e mija. Është mirë të kesh synime, sepse kështu, i jep vetes arsye për të provuar më tej, për të guxuar, vepruar dhe jetuar! Ashtu siç mu prezantua papritur bota e bukur e kinematografisë, ashtu dhe mund të njihem

ndonjëherë tjetrin (qesh). U njohëm gjatë periudhës që unë isha aktivizuar dhe caktuar për prezantinim e eventit 'Miss Universe Albania'. Pas aaj, mund të them që çdo gjë mori rrjedhën e saj të natyrshme. Padyshim kaluam goxha vështirësi, kapërcyem pengesa të shumta, përjetuam ditë të vështira, por njohëm njëritjetrin më tepër në këto çaste, dhe dashuroam njëritjetrin edhe më tepër: kur kishim një dorë për të zgjatur e një për të marrë, sa herë që rrezoheshim, të ngriheshim bashkë edhe më mirëkuptues, më të qetë, më të zgjuar, më të lidhur. Jemi zhvilluar shumë falë çdo ndodhie në lidhjen tonë, në relatata me individë të jashtëm, në të kuptuarit e tyre, të kuptuarit e njëritjetrit, dhe vetvetes njëkohësisht; të mirat, të këqijat, frikërat që deri tani i dinim joekzistente, gjithçka. Dhe tani mund të them se jam vërtetë e lumtur që jam njohur me atë njeri, të cilin po i besoj gjithçka me synimin për ta patur përkrah meje gjatë gjithë këtij rrugëtimi fantastik që e quaj jetë.

Keni plane për martesë së shpejti?

E kemi menduar, si çdo çift që mund ta çojë ndërmend të paktën një herë, qoftë rastësisht. Do jetë e kuptueshme për të ndodhur një ditë. Ka për të qenë një ndër çastet më të bukura të jetës sonë, por momentalisht nuk kemi ndonjë plan për martesë për të ardhmen e afërt. Por siç thashë pak më parë, preferoj magjinë surprizuese që e karakterizon jetën, kështu që mbase Zhaneta e të ardhmes mund të mos jetë dakord me Zhanetën e tanishme.

Cila është motoja në jetën tuaj apo ajo që ju frymëzon çdo ditë?

Frymëzimi im është të jem në rrugëtim të palodhur të njohjes së vetes sime. Të provoj veten në çdo fushë, të shfaq interes për gjëra që më pëlqejnë, të kam refuzuar si të kota ose të merrtishme. Të mos harroj kuptimin që i kam gjetur vetë jetës time: mos ndalo së jetuari. Mund të duket si ndonjë varg tipik i një trillimi me tematikë fetare ose spirituale, por kjo është ajo e cila, ndër të tjera, më shtyn të mendoj pozitivisht, të vazhdoj të bëj atë që më fal buzëqeshje dhe që më frymëzon për më tej çdo ditë. Do doja të shtoja dhe diçka në fund. Një shprehje të parapëlqyer nga një ndër mjeshtrit prolixik të shkrimit, Charles Bukowski.

"My Dear,

Find what you love and let it kill you. Let it drain you of your all. Let it cling onto your back and eigh you doën into eventual nothingness. Let it kill you and let it devour your remains. For all things ëill kill you, both sloëly and fastly, but it's much better to be killed by a lover.

-Falsely yours"
(E dashur,

Gjej atë që ti do dhe lëre të të vrasë. Lëre të të përthith në të gjithë tërësinë tënde. Lëre të kapen në shpinën tuaj dhe të peshojnë në asgjënë tuaj. Lëre të të vrasë dhe të përpjeh mbejten e tua. Sepse të gjithë gjërat do të të vrasin si ngadalë edhe shpejt, por është më mirë të vritesh nga ajo që do.

Gënjeshtrërisht i joti)
Faleminderit!



më vonë me një fushë tjetër pas së cilës mund të magjepssem edhe më tej. Preferoj të mos ia mohoj vetes këtë magji të papritshmërive të jetës.

Së fundmi jeni fejuar me drejtorin e TALELLI Productions, Blertin. Si nisi historia e dashurisë suaj?

Historia jonë ishte një histori e destinuar të niste... herët a vonë (qesh). Nga ç'kam kuptuar së fundmi, unë dhe Blerti kemi rastisur me mijëra herë në të njëjtat evente, organizime e festa përpara se të njiheshim, por për arsye që do ngelen gjithnjë mister për mua, asnjëherë nuk jemi takuar. Madje, një herë, para shumë vitesh, më kujtohet që isha pjesëmarrëse në një aktivitet mode këtu në Tiranë, në të cilën Blerti ishte caktuar të filmonte, dhe mund të ketë qenë kontakti më i afërt që mund të kemi patur, ku asnjëri nga ne të dy nuk kujtonte dot as të kishte parë

cili ka kursyer për ndërhyrje kozmetike me shpresë që t'i hapen rrugë në fushën e modës, si synimin e vetëm të të pasurit pak më tepër ndjekës në Instagram por jo vetëm. Mund të jetë zgjidhje e përkohshme, por për mendimin tim kjo do ishte sikur të mbulosh diellin me shoshë. Fusha e modës dhe nënfushat e saj janë shumë më tepër se aq. Mbase koncepti i modelingut në dukje është tejet sipërfaqësor për shumicën. Por kuptimi i të qenit i përfshirë në atë fushë, shkon përtej asaj që shohin sytë e çdo njeriu të zakonshëm kur shikojnë pasarella apo sete fotografike. Individualiteti është çelësi i suksesit të çdo fushe. Kultura historike, kriteret dhe rregullat janë të rëndësishme, por individualiteti do jetë gjithnjë ajo që do ju veçojë dhe do ju prijë drejt suksesit, e në shumë raste edhe drejt njohjes së mëtejshme të vetvetes



Nga Aurora te William Zeneli, talentet e reja që do të shpërthejnë së shpejti

Artistët shqiptarë që pritet të pushtojnë mbarë botën

Kush me muzikë, me modeling apo fotografi, yjet që na bëjnë krenarë jashtë vendit

Pamela Aliaj

Pej kohësh e kemi vërtetuar se shqiptarët, sidomos artistët, me shumë mund e punë mund të arrijnë të kenë sukses e të bëjnë krenar një komb të tërë. Të shumtë janë ata që janë tashmë të famshëm e që rrënjët e tyre nuk i kanë harruar duke i bërë të ditur edhe botës se nga vijnë. Nëse do t'i mblidhnim të gjithë do të bëheshin shumë por në listën tonë do të vendosim vetëm disa prej tyre të cilët janë talente të reja. Ato pritet ashtu si Rita Ora apo Bebe Rexha të pushtojnë botën me talentin e tyre. Gjithashtu zbuloni disa prej artistëve, piktorëve dhe këngëtarëve shqiptarë më të famshëm, punët e të cilëve njihen në të gjithë rruzullin tokësor e me të cilat na kanë bërë tepër krenarë:

AURORA ZEKA

Aurora Zeka (15) vjeçarja e cila është pjesë e kompanisë muzikore 'On Record' ka startuar mirë në muzikë. Vajza ka mijëra ndjekës në Instagram dhe është mjaft e dashur nga fansat e saj. E për të së fundi ka shkruar edhe e njohura 'Blick'. Në artikullin për Aurorën thuhet se ajo ka lidhur një kontratë 10 vjeçare me On Record në Kosovë dhe se si fëmijë dëshironte të bëhej këngëtare. Vajza e cila me origjinë është nga Kosova, por jeton në Zvicër ka treguar se ka qëllime të mëdha në karrierën muzikore, e që synon të njihet edhe ndërkombëtarisht. "Unë dua të jem Ariana Grandë e dytë. Ëndërr të bëj një turne botëror", ka shtuar Aurora. Por pavarësisht muzikës të cilës i është përkushtuar, vajza e cila tani po ndjek klasën e nëntë thotë se dëshiron t'i vazhdoj studimet për Drejtësi, në Hardëard.

KLAUDIA PEPA


Klaudia Pepa është një nga balerinat më të suksesshme shqiptare, e cila tashmë prej vitësh vijon karrierën e saj në Itali. Së fundmi balerina e njohur ka publikuar në Instagram një video ku shihet duke performuar me grupin e saj të kërcimit, në rrugët e qytetit me këngën e këngëtarit të njohur, Jason Derulo. Balerina fitoi famë në Itali pas pjesëmarrjes në Amici me Maria de Filipin ku edhe u bë pjesë e trupës së baletit. Pas asaj experience, Klaudias i janë hapur shumë porta dhe është një ndër balerinat më me premisa për të na bërë edhe më shumë krenarë në të ardhmen.


ADRIAN PACI

Adrian Paci është një prej artistëve bashkëkohorë më të famshëm në Shqipëri dhe Europë. I lindur në Shkodër, ai u diplomua në Akademinë e Arteve në Tiranë dhe më pas vajti në Milano, Itali. Punimet e tij, që shpesh herë prekin tema si nostalgjia, ndarja dhe paraja, mund të admirohen në shumë muze dhe galeri artesh në botë. Paci ishte artisti i parë shqiptar që përfaqësoi Vendlin e Shqiponjave në Bienalen e Venecias në vitin 1999.

RITA ORA

Rita Ora është një këngëtare britanike, aktore dhe modele e lindur nga prindër shqiptarë në Prishtinë, kryeqyteti i Kosovës. Prindërit e saj u larguan nga Kosova kur ajo ishte vetëm një vjeç dhe vajtën në Londër, ku ajo u rrit me familjen e saj. Ajo u bë e famshme në vitin 2012 me këngën në bashkëpunim me "DJ Fresh", "Hot Right Noë". Që prej asaj kohe ajo ka nxjerrë shumë hite që janë me





famë botërore.

DUA LIPA

Një tjetër yll me origjinë shqiptare është e bukura Dua Lipa. Prindërit e saj migruan në Britani të Madhe në vitin 1990 për shkak të dhunës dhe shqetësimeve dhe Dua u lind në Londër. Dua Lipa ka nxjerrë shumë këngë të bukura dhe të famshme në bashkëpunim me artistë të mëdhenj, si Sean Paul dhe Calvin Harris. Pa asnjë dyshim ajo është një nga artistet femër më premtuese në botë.

BEBE REXHA

Këngëtarja, kompozitarja dhe producentja amerikane, Bleta "Bebë" Rexha ka rënëj Shqiptare. Prindërit e saj janë me origjinë etnike shqiptare nga dy qytete të ndryshme në Maqedoni. Ata vajtën në Bruklin, Nju Jork, ku Bleta lindi në vitin 1989. Ajo ka shkruar shumë këngë për këngëtarë të famshëm, përfshirë Rihanna dhe Eminem. Ajo ka publikuar gjithashtu shumë hite si "Meant to Be" dhe "I Can't Stop Drinking About You."

ERA ISTREFI

Era Istrefi është një këngëtare shqiptare dhe kompozitore e lindur në Prishtinë, Kosovë. Motra e saj Nora Istrefi është gjithashtu një këngëtare. Era Istrefi bëri debutimin e saj pesë vite më parë në vendin e saj dhe më pas në vitin 2016, ajo u bë e njohur në të gjithë botën me këngën "Bon Bon", një këngë e shkruar në anglisht me fjalinë në shqip.

ERMAL META

Ermal Meta është një këngëtar italo-shqiptar dhe kompozitor i lindur në qytetin jugor të Shqipërisë, Fier. Ai fitoi festivalin prestigjioz të Sanremo në shkurt 2018 me një këngë të bukur që i dedikohet viktimave të luftës. Ai morri pjesë edhe në festivalin e Eurovizionit duke përfaqësuar Italinë.

ELENI FOURIERA

Pas disa vitesh karrierë të suksesshme artistike në Greqi, këngëtarja Eleni Foureira më në fund ka vendosur të thotë të vërtetën, duke pohuar se nuk ka origjinë nga Meksika, por ka lindur në Fier, në Shqipëri. E cilësuar si Shakira e Greqisë, Eleni Foureira në fakt është Entela, një vajzë emigrante shqiptare. Duke folur për një revistë greke, Eleni ka thënë se është vajza e Kristaqit nga Fieri dhe Marietës nga Vlora, dhe ka lindur në Fier në vitin 1987. Eleni Foureira ka qenë ndër këngëtarët më të suksesshëm të vitit që lamë pas. "Fuego" kënga me të cilën ajo konkurroi në Eurovizionin dhe Eleni një famë në të gjithë Europën. Së fundmi mediat greke kanë bërë të ditur se këngëtarja me origjinë shqiptare do të vijë në një bashkëpunim me Snoop Dog, një nga emrat më të mirë të muzikës hip-hop. Kënga titullohet "Sirens" dhe do të jetë një "remake" i këngës legjendare të Eurythmics Sweet Dreams (Are Made of This).


Bashkëpunimi do të publikohet ditën e premte por pak më parë ka dalë një pjesë shumë e shkurtër nga xhirimet e klipit.

ACTION BRONSON

Arian Asllani, i njohur ndryshe si Action Bronson, është një reper amerikan, yll i "reality show" dhe shef kuzhine që ka lindur në vitin 1983 në qytetin e Nju Jorkut nga një baba shqiptar mysliman dhe një nënë amerikane hebreje. Gjatë karrierës së tij, ai ka punuar me artistë të famshëm si Eminem, Wiz Khalifa, Prodigy, dhe Kendrick Lamar.

WILLIAM ZENELI

Është një nga këngëtarët më të dashur shqipëtar. Vokali brilant që posedon po dhe pamja prej një djaloshi shumë simpatik ka bërë që 1Million të cilsohet si "Stuhia" që ka goditur industrinë muzikore shqiptare. Këtë e dëshmon numri i madhë i fansave që artisti në fjalë ka në rrjetet sociale. I lindur dhe rritur në Itali artisti në fjalë famën e ka shtrirë dhe përtej kufive. Ishte moshë 6 vjeqare që William Zeneli apo i njohur me emrin artistik si 1Million për herë të parë ndejoi disa këngë të reperit Amerikan 50 Cent dhe pse nuk e njihje ai u dashurua marrezisht në stilin e të kënduarit dhe stili Hip Hop u bë udhërrefyesi i artistit të ri. 1 Million nuk është thjesht vetëm këngëtar ai është një tekshkrues i shkelqyeshëm. Artisti i ri shqiptar është këngëtar i shumë shpejt do na bëjë krenar në botë. Vullneti për punë, pamja prej një djaloshi të kompletuar dhe pa diskutim talenti që posedon janë vultat që dëshmojnë që artisti do ngritet lart në industrinë muzikore Botërore.



Flet këngëtarja shqiptare: Kam përjetuar shumë racizëm në Zvicër

Ekskluzive/ Rrëfëhet ylli i ri i popit,

ILIRA GASHI:

Bashkëpunimi i ardhshëm? Do të pyes Britney Spears

“Bebe Rexha, Dua Lipa dhe Rita Ora mbase presin të bëjmë këngë bashkë”

Pamela Aliaj

Të çash në botën e muzikës është shumë e vështirë ditët e sotme dhe sidomos nëse bëhet fjalë për një konkurrencë ndërkombëtare. Artistët shqiptarë, në një mënyrë apo në një tjetër ia kanë dalë të bëjnë emër në botën e egër dhe të bukur të muzikës. Një ndër zërat e rinj që ka shumë premisa për të arritur majat në të ardhmen e afërt është dhe Ilira Gashi. Për herë të parë, shqiptarja që ka firmosur kontratë me shtëpinë diskografike Sony, na rrëfen ekskluzivisht për “Bluetooth” të “Gazeta Shqiptare” vështirësitë që ka hasur dhe suksesin që po shijon si një këngëtare popi. Ilira na tregon për vështirësitë e hasura në jetë si dhe për mënyrën se si ajo tani ndihet e plotësuar dhe e realizuar në ëndërrën e saj të fëmijërisë. Një bashkëpunim me Bebe Rexhën, Dua Lipën dhe Rita Orën? Një yll në rritje, Ilira Gashi do të na bëjë akoma më tepër krenarë në rrugëtimin e nisur të saj në muzikë ku edhe mund ta shohim në një bashkëpunim me yllin e pop-it, Britney Spears. Gjithçka e zbuloni



në intervistën ekskluzive të mëposhtme.

Jeni një nga këngëtarët shqiptarë që jeton jashtë vendit ku po ecën shumë mirë në tregun muzikor të huaj. Sa e vështirë është të kesh sukses në këtë kohë në një konkurrencë kaq të egër?

Artistët kanë konkurrencë shumë më të madhe se dikur, dhe muzika po prodhohet në masa, por interneti dhe pavarësia e artistit nga Firmat muzikore (Record labels) kanë krijuar një liri që nuk ekziston në të njëjtën mënyrë si sot. Konkurenca gjithashtu nuk do të thotë vetëm vështirësi po do të thotë edhe se çdo artist në botë e ka mundësinë të krijojë një karrierë pa ndihmën e madhe të firmave që një para disa kohësh kanë dominuar dhe vendosur industrinë. Të gjithë mund të tregojnë se çfarë mund të bëjnë.

Së fundmi keni nxjerrë këngën tuaj “Do it for yourself”. Për çfarë flet kënga? Si u frymëzuar për të dhe realizimin e saj?

Kur isha duke vizituar mikun dhe menaxherin tim më të mirë Jaro Omar, folëm për Disney dhe përrallat për një kohë të gjatë. Ne filluam të analizonim të gjitha përrallat dhe arritëm në përfundimin se gratë janë portretizuar qëllimisht si të dobëta dhe nevojtare. Ata janë gjithmonë të reduktuar në pamjen e tyre dhe pa një princ, asgjë s’ka vlerë kështu. Pra, ne donim t’i ofronim botës një kundër-histori, një përrallë më të mirë dhe më origjinale, ku gratë janë të forta edhe pa princ.

Çfarë projekti keni të radhës në muzikë?

Që nga gushti publikoj një

këngë të re çdo dy muaj. Ka shumë bashkëpunime me artistë të tjerë ndërkombëtarë. Do të lëshoj një EP dhe do të shkoj në turne në fund të këtij viti.

Shtëpia diskografike Soni ju ka dhënë mundësinë e artë për të qenë pjesë e botës së muzikës. Sa ju ka ndihmuar kjo kontratë deri më tani?

Shtëpia diskografike nuk është kurrë një garanci e suksesit. Ajo të ndihmon të sillni muzikën tek njerëzit si një artist, në mënyrë që bota t'ju shohë dhe t'ju njohë. Nëse dikush arrin të bëjë njerëzit dhe publikun për vete dhe që ato t'i dëgjojnë dhe duan këngët, vendoset nga publiku. Megjithatë, një ekip i mirë ndonjëherë mund të shesë çdo artist të keq sa më mirë.

Do të dëshironit të bënit ndonjë bashkëpunim me ndonjë reper apo këngëtar të njohur të huaj? Cili/ Cila do të ishte nëse po?

E para që do pyes për një bashkëpunim është Britney Spears.

Ajo është arsyeja pse une nisa të bëj muzikë kur isha 6 vjeçare.

Do ishte një ëndërr të bëj një këngë për të ose me të.

A keni në plan të realizoni ndonjë bashkëpunim së shpejti?

Unë xhirona videon për këngën time të re në Puerto Rico të dielën e kaluar, e cila është shfaqur nga një yll latin. Kënga realizohet në maj me videoklip.

Në një intervistë të shkruar keni thënë se "janë tallur me ëndrrat e tua"? Kush kanë qenë ata që nuk besonin në talentin tënd dhe pse një sjellje e tillë?

Njerëzit besojnë vetëm atë që shohin. Shumë e nënvlerësojnë vullnetin dhe këmbënguljen e një artisti të talentuar. Njerëzit sot kanë shumë urretje dhe hidhërim në zemrat e tyre. Ata gjithmonë kanë më shumë gjasa të nënvlerësojnë dikë sesa të besojnë tek ta. Dua vetëm që familja ime të besojë në mua. Gjithkush tjetër ose mund të kënaqet me mua ose të më shikojë të arrij ëndrrat e mia.

A keni patur ndonjë diskriminim apo bullizëm në shkollë? Po ndonjë diferencim



për shkak të prejardhjes?

Unë jam bija e një luftuesi, nëse është e nevojshme unë kafshoj kokat, njerëzit kanë respekt për mua, ndoshta edhe pak frikë.

Mua njerëzit nuk më kanë ngacmuar kurrë direkt por shpesh u shtypa nga disa zvicëranë se ata mund të përfitonin nga pozitat e tyre më të larta. Unë kam përjetuar shumë racizëm sepse isha shqiptare në Zvicër dhe jam tani shumë e lumtur që jetoj në Berlin, ku njerëzit më shikojnë me entuziazëm kur them që unë vij nga Kosova dhe Shqipëria.

Keni thënë në intervistë gjithashtu se çdo këngë e juaja është fletë e ditarit të jetës suaj që flet



për lëndimet e zemrës dhe betejën e rritjes. Cila është beteja më e vështirë e llirës që do doje ta shfaqje në një këngë tënden?

Do të kisha turp të shkruaja këngë që nuk kanë histori të vërtetë. Çdo gjë që them në këngët e mia, ndodh me të vërtetë. Unë nuk flas aq shumë për dashurinë, sepse jam shumë e lumtur dhe përveç kësaj, është gjëja më e lehtë në botë për të shkruar një këngë dashurie. Megjithatë, do të kem disa këngë për marrëdhëniet që janë pak më të çmendura. Unë shkruaj për gjërat e rëndësishme në jetë që pop artistët rrallë adresojnë. Vetëdijshimi, vetëbesimi, çrregullimet e identitetit, problemet mendore, kritikata shoqërore, fem-

inizmi.

Keni thënë se do të dëshironit që të zhvillonit dhe një tur nëpër botë. Keni ndonjë plan ta realizoni së shpejti? Po në Shqipëri kur do të kaloni?

Turne im europian fillon në fund të vitit, Shqipëria dhe Kosova definitivisht janë të gatshëm.

Jeni vajza e një babi nga Kosova dhe mami nga Shqipëria. Si u njohën prindërit e tu dhe kur emigruan në Zvicër? Sa e vështirë ka qenë jetesa aty?

Mamaja është nga Tirana dhe Babi është nga Prishtina. Ata u takuan në Durrës, të dy ishin me pushime me familjet e tyre. Menjëherë pas kësaj, ata u martuan dhe imigruan në Zvicër. Atje kam lindur unë. Prindërit e mij punuan ditë e natë për të financuar mua dhe motrën time dhe për të na krijuar një jetë të mirë neve. Nëna ime sapo kishte mbaruar studimet e saj mjekësore dhe ishte jashtëzakonisht e vështirë të njihesh në Zvicër, ajo arriti me djersë dhe shumë punë ëndrrat e saj për të qenë doktoreshë në Zvicër. Babai im ngrihet çdo mëngjes në orën 4 të mëngjesit për shkak të vajzave të tij. Ata mund të shkruanin një libër për atë se sa luftuan. Unë dua të bëj gjithçka për t'i bërë të lumtur dhe krenarë. Unë do të vdisja për ta, ata janë heronjtë e mi, ata janë modelet e mia. Unë dhe motra jemi vajzat më të lumtura në botë.

Cila është ëndrra më e madhe e llirës? Do të pranojë të bashkëpunojë me shqiptarët e tjerë në bote si Dua, Rita dhe Bebe për të sjellë diçka unikë?

Ëndrra ime tashmë është përm-bushur. Jetoj mirë nga muzika ime. Mund të shkoj në studio çdo ditë dhe të bëj atë që dua. Familja dhe miqtë e mi janë mirë. Unë vetëm dua të gëzoj jetën çdo ditë dhe të jem artisti më i mirë që mund të jem. Unë nuk mund të pres që të kënaqem me pamjen në frone të mbretërëshave shqiptare si Dua, Rita dhe BEBE dhe t'i bëjmë me një gotë verë në Shqipëri dhe Kosovë. Se nuk kuptoj pse ato nuk kanë bërë këngë që më parë bashkë. Ndoshta ato më presin dhe mua.

Nga këngëtarët shqiptarë kë preferoni më tepër?

Bebe Rexha gjithmonë ka pasur për të luftuar shumë për suksesin e saj. Ajo ka shumë karakter dhe tregon të gjitha emocionet e saj hapazi. Ajo më bën të qesh. Dëgjoj këngët e tyre 24 orë në ditë. Përveç kësaj, ajo gjithmonë shkruan këngët e saj së bashku me të tjerët.

Cila është motoja juaj apo muza që ju frymëzon çdo ditë të jetës suaj?

Motoja ime është: Do it yourself! (Bëje vetë!). Merrni gjithçka në duart tuaja. Nëse jeni të pakënaqur ose dikush ju bën të pakënaqur, jeni përgjegjës për luftimin dhe ndryshimin e gjërave.

A është e dashuruar llira? Do të realizoni një këngë tuajën dedikuar kësaj ndjenje?

Unë kam qenë me Jumpa për 3 vjet tashmë. Ai ndonjëherë prodhon dhe shkruan këngët e mia me mua. Jumpa i përket familjes dhe më bën të pafundësisht të lumtur. Ne kemi disa bashkëpunime që do të vijin në të ardhmen.



Dje në "Koha Ditore"

Elaborimi intelektual i zyrtarëve të Kosovës e Shqipërisë të ideve të Dobrica Qosiqit

Nga Veton Surroi

(vijon nga faqja 1)

1. ... të gjithë e dinë për çka bëhet fjalë, shumica madje qesh.

Barsioleta, të cilën as unë nuk po e tregoj, hyri në punë gjatë tërë vitit të kaluar, ndërsa përfilitje koncepti i këmbimit të territoreve mes Kosovës dhe Serbisë dhe një personalitet i njohur prokosovar i Kongresit Amerikan u zu në befasi kur shkoi për të folur me përfaqësues të lartë të administratës amerikane dhe në pyetjen përse administrata amerikane shyn përpara idenë, gjithnjë deri atëherë të papranueshme, të këmbimit të territoreve dhe popullsisë në bazë etnike, mori përgjigjen nga zyrtari i lartë i administratës:


- Nuk po e kërkojmë ne, po e kërkojnë kosovarët.

Rrëfimi anekdotal ka një rreth të plotë të barsioletës. Ideja për ndarje etnike dhe, konkretisht për kufijtë e rinj shqiptarë e serbë, e lindur ndër akademikë nacionalistë serbë, të identifikuar me Dobrica Qosiqin dhe e prezantuar diplomatëve amerikanë, që në tetëdhjetat e pastaj të nëntëdhjetat e shekullit të kaluar, iu prezantua amerikanëve për herë të parë si opSION kosovar në dhjetëvjetorin e Pavarësisë së Kosovës.

Brenda kontekstit të barsioletës, zyrtari i administratës amerikane, dhe kjo është ndoshta metaforë më e gjerë për të gjitha ankesat që bëjnë kosovarët ndaj diplomatëve amerikanë dhe evropianë, e dha një përgjigje të thjeshtë: mos e kërko arushën te ne.

2.

Kosovarët që folën me argumentet e Arushës janë lehtë të identifikueshëm; numri i zyrtarëve të lartë shtetërorë të Kosovës që janë angazhuar për idetë e Dobrica Qosiqit mbetet në një. Numri i përkrahësve publikë, qoftë si vartës në Kosovë, qoftë si aventurierë në Shqipëri, mund të ketë qenë edhe pak më i madh, por mezi i kalon gishtërinjtë e një dore. Dhe ndonëse mund të duket me rëndë-



si se kush u prezantua publikisht si vartës apo si aventurier, ndoshta më me rëndësi është që të shënohen argumentet e, ta quajmë ashtu, narracionin të Arushës, të cilat iu servuan opinionit publik me arrogancën që rëndom e ka vetëm injoranca.

T'i marrim, atëherë, tri shpjegime të Arushës.

Një: pse ky preokupim me kufijtë, kur tashmë kufijtë e ish-Jugosllavisë kanë ndryshuar me pavarësinë e Kosovës?

Dy: të gjithë ata që klithin kundër këmbimit të territoreve, se gjoja kjo do të sjellë kataklizëm në region, duhet të kujtohen se e njëjta gjë thuhet se do të ndodhte edhe me pavarësinë e Kosovës, se ditën kur do të shpallej pavarësia, do të iknin të gjithë serbët nga Kosova dhe do të shpërthente dhuna gjithandej.

Dhe tre: çka mërztimi në për Bosnjën a Maqedoninë? Nëse këmbimi ynë territorial na hyn neve në punë, çka po lodhemi në për Bosnjë a Maqedoni, ku mund të ketë trazira për këmbime etnike territoriale?

3.

Arusha nuk ka mundur t'i zgjidhte tri argumentet më të mira.

Një, deklarimi i një zyrtari shqiptar (i Kosovës dhe Shqipërisë) se çfarë është problemi i ndryshimeve kufitare kur kufiri i ish-Jugosllavisë ka ndryshuar me pavarësinë e Kosovës, është pjesë e narracionit që e ka bërë Serbia që nga pavarësia e Sllovenisë (shumë më herët se ajo e Kosovës). I tërë narracioni juridik i Beogradit është se po ndryshohet, me dhunë të tërjerë, një shtet sovran, prej të cilit po i këputen pjesët. E vërteta, tashmë e sanksionuar në të drejtën

ndërkombëtare, është se ka ndodhur një çinteprim i ish-Jugosllavisë dhe pjesë e atij çinteprimi janë shtetet e pavarura, mes të cilave edhe Republika e Kosovës. Ky narracion juridik u vërtetua së fundmi me mendimin e GjND-së rreth të drejtës së Kosovës për të shpallur pavarësinë.

Por, kur një person zyrtar shqiptar thotë se me pavarësinë e Kosovës kufijtë kanë ndryshuar, atëherë Kosova paska një faj në të drejtën ndërkombëtare që do shlye. Dhe, ai faj mund të shlyhet me vendosje kufijsh të rinj.

Dy, deklarimi i një zyrtari të Kosovës (i cili kishte shpallur para një pesë vjetësh se Kosovës i janë liberalizuar vizat, por për këtë deri më sot nuk paska dëgjuar Bashkimi Evropian) se shpallja e këmbimit territorial është e njëjtë me shpalljen e pavarësisë - nuk do të

trembet kush, nuk do të ketë kurrfarë pasojash - mund të ketë qëllimin më të mirë për shpjegimin e argumentit të Arushës, por nuk i bën mirë krahasimit. Shpallja e pavarësisë së Kosovës ka qenë - ta përkufizojmë në një formulë të thjeshtë - fryt i konsensusit më të lartë të mundshëm mes Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, ndërsa shpallja e arritjes së një marrëveshjeje për dëbim të sa më shumë serbëve nga Kosova dhe të shqiptarëve nga Serbia mund të jetë fryt i një marrëveshjeje mes Arushës dhe partnerëve të saj. Paralella e vë në kandar shpalljen e pavarësisë, si aktin madhor politik të sovranitetit, me çfarëdo pazaritë ditor që të bëjnë politikanët e kësaj apo garniturës së ardhme. 'Arusha' vetëm duhet të identifikojë, siç ka bërë tani, se cila garniturë i hyn në punë.

Dhe tre: çka mërztimi në për Bosnjë e Maqedoni? Pyetjen mund ta bënte një banor i Fihxit apo njëri prej arrogantëve në oborrin e të vetmit përkrahës të konceptit të Dobrica Qosiqit në pushtetin e sotëm të Kosovës. Pos solidaritetit bazik njerëzor, aty hyn edhe një element i shpërfillur prej partnerëve të Arushës: parimësia. Lufta në Bosnjë është zhvilluar në bazë të rivizitimit të kufijve e lufta në Maqedoni, falë Marrëveshjes së Ohrit dhe rolit vendimtar të shqiptarëve në të ka përfunduar mu duke penguar idenë e ndarjeve territoriale-etnike. Pavarësia e Kosovës është shpallur, në fund, mu falë këtij parimi, të tërësisë multietnike. Leksioni i thjeshtë, që nga rrëfimet në shkolla fillore, është se nuk mund ta shpëtosh shtëpinë tënde duke ndihmuar që të digjen shtëpitë e fqinjëve.

4.

Ka sinjale gjithandej regionit, Evropës e SHBA-ve, se është duke u konsumuar aventura - ideja e këmbimeve territoriale.

Por, sikundër barsioletat, edhe atëherë kur harrohet rrëfimi e mbetet fjalia e fundit - si në "a je me mu a me arushën" - rrëfimet e Arushës do të mbeten. Do të kërkojnë jetëgjatësi.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



Opinioni **i** Ditës

Rritja ekonomike: në dorë të Zotit apo lekut?

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faja 1)

... shumta. Zoti nuk na ndihmon edhe për këtë vit. Gjendja hidrike nuk duket në favor të një prodhimi energjistik si ai i të njëjtës periudhë vitin e kaluar. Lajmi i rritjes më të pakët të eksporteve shqiptare për dy muajt e parë të këtij viti, në krahasim me janar-shkurtin 2018 duhet të na shqetësojë. Motori i vërtetë i një rritjeje të qëndrueshme ekonomike mund dhe duhet të jetë tek ne shtimi i kreditimit. Huadhënia nga bankat duhet të shndërrohet në një interes parësor kombëtar. Po pse? Sepse motori tjetër aq premtues për vite me radhë, investimet e huaja të drejtpërdrejta, po cedojnë rrugës. Për këtë vit, dy projektet e mëdha me vlerë tërësore 2.1 miliardë euro, TAP dhe të dy hidrocentralet mbi lumin Devoll do të japin apo jo rreth 300 milionë euro. Kur na kanë mësuar me një kontribut vjetor mbi 650-700 milionë euro këto dy vitet e fundit. Arsyeja është e thjeshtë: po përfundojnë së ndërtuari. Për vitin 2020 mund edhe të sjellin vetëm 30 milionë euro investime. Po me çfarë do të zëvendësohen? Programi i qeverisë për partneritetet publik-privat, për të zëvendësuar investimet e huaja të drejtpërdrejta që po mpaken, nuk duket zemërdhënës. PPP-të kanë shumë probleme, dritëhije dhe nuk sjellin kapital të huaj shtesë, pasi fituese të tenderëve shtetërorë për ta janë vetëm kompani vendase. Prandaj edhe sytë duhen kthyer nga kasaforat e 14 bankave tregtare që veprojnë tek ne. Nga depozitat e popullatës. Si popull jemi kursimtarë dhe e ruajmë paranë. Mirëpo e kemi nxjerrë nga sëndukët dhe e kemi futur nëpër banka. Kemi rreth 7 miliardë euro, dollarë dhe lekë depozita nëpër banka. Nga këto, vetëm një e katërta i kthehet ekonomisë në formën e huave dhe kredive, si për biznesin ashtu edhe për qytetarin. Pra "karburanti" për të ndezur motorin e ekonomisë nëpërmjet rritjes së kreditimit është i gjithi aty: me miliardë euro! Mjafton të përdoren. Sektori ynë bankar mban kursimet e shqiptarëve, por duhet të shtyhet nëpërmjet fitimit që këto kurse me t'i vendosë në dispozicion të rritjes dhe të zhvillimit të vendit. Pa kredi nuk ka rritje, dhe pa rritje, kursimet e humbasin vlerën e tyre. Ambicia jonë si vend duhet të shkojë përtej normave të rritjes ekonomike 4 për qind në vit. Banka qendrore, Banka e Shqipërisë provon të nxisë më shumë kreditimin. Por gjysma e sforcove të saj nuk ka duk, pasi gjysma e shitblerjeve tek ne bëhet në euro. Sikur ministria e Financave dhe Ekonomisë do të merrte nismën të kufizonte përdorimin e euros dhe të nxirrte lekun mbret! "Çdomethënë



kjo?", mund të pyesë gjithkush. Në vendin tonë gjithçka këmbëhet në euro. Shtëpitë blihen në euro, kreditet merren në euro apo dollarë. Makinat blihen në euro. Sendet shtëpiake me një vlerë të lartë relativisht, si televizorët, frigoriferët, lavatriçet, etj., vlerësohen në euro. Madje edhe huatë mes njeritjetrit, shumë prej nesh i japim dhe marrim në euro. Pavarësisht se leku ynë ka mbi dy dekada që është i qëndrueshëm. Edhe në restorante e hotele pagesat kryhen lirshëm në euro. Shumica prej nesh këtë e konsiderojnë liri tregtare dhe kanë deri diku të drejtë. Mirëpo, kur vjen puna për përfitimet ekonomike në rang të ekonomisë sonë kombëtare, nëse veprimet me euro do të përqendroheshin vetëm tek zyrat e "ex-

change"-it, tabloja ndryshon. Është e vërtetë se "isha te çejnxi" e thonë edhe shumë syresh prej nesh, pasi këmbëjnë eurot (krjesisht) ose dollarët që kanë me lekë, ose e kundërta. Mirëpo jemi të pandërgjegjësuar që një takim të tillë me zyrat e këmbimit valutor e kanë me dhjetëra herë më shumë vende të ngjashme në fuqinë blerëse me ne, por që kanë siguruar forcim të ndjeshëm të ekonomisë së tyre vetëm falë rregullit të fortë që mbajnë që transakcionet të bëhen në monedhën e tyre kombëtare. E bën Maqedonia e Veriut, duke ruajtur dinarin e saj. E bën dhe Serbia për dinarin e vet. E bëjnë akoma dhe më fort Polonia me zlotin(monedha polake) apo Kroacia me kunën e vet. Po ne? Ne për 29 vite e kemi lënë të lirë lekun të

këmbëhet me monedhat e huaja dhe mirë kemi bërë! Por nga ana tjetër, mund të kishim vendosur një regjim të tillë rregullash, duke kufizuar këmbimin e monedhës sonë vetëm në zyrat e këmbimit valutor(që ne i thërresim "çejnxe"). Kështu do të forconim ndjeshëm pozitat e ekonomisë sonë kombëtare. Po pse? Sepse duke kërkuar që këmbimet në restorante, hotele, blerje mallrash e shërbimesh në territorin e Republikës sonë të bëhen vetëm në lekë(pavarësisht këmbimit të lirë me euron, dollarin, etj.) përçojmë më mirë politiken monetare(të parasë). Në këtë mënyrë, kosto e parasë që mbahet në nivele shumë të ulta nga banka jonë qendrore, përcillet në vendimet për kredi dhe kreditet në lekë bëhen më të lira. Qeveritë polake, kroate apo këtu afër nesh edhe ajo e Maqedonisë së Veriut, kanë qenë shumë të qarta dhe të vendosura për këtë dhe aplikojnë me të drejtë gjoba të kripura, kur konstatojnë pranim të shërbimeve apo shitjes së mallrave nga restorante, hotele, kompani e agjenci vendase në monedhë të huaj. Duhet ta bëjmë edhe ne, duke e shpallur këtë vit, vit të kreditimit dhe përdorimit të lekut. Vetëm të mira do të kemi.

Si popull jemi kursimtarë dhe e ruajmë paranë. Mirëpo e kemi nxjerrë nga sëndukët dhe e kemi futur nëpër banka. Kemi rreth 7 miliardë euro, dollarë dhe lekë depozita nëpër banka. Nga këto, vetëm një e katërta i kthehet ekonomisë në formën e huave dhe kredive, si për biznesin ashtu edhe për qytetarin.

HOROSKOPI

DASHI

Këtë të shtunë rekomandohet të mbani nën kontroll emocionet dhe të bëni kujdes me veprimet. Në një moment mund të përjetoni pakënaqësi me veten dhe trishim, për shkak të së kaluarës. Përpiquni ta kaloni këtë situatë dhe të ecni përpara duke menduar me pozitivitet.

DEMI

Në pjesën më të madhe të ditës Demat do të jenë të kënaqur. E shtuna prëmton takime miqësore, udhëtime të shkurtra dhe shkëmbim idesh. Blerjet e mëdha ende nuk janë të mirëpritura. Në dashuri, të lindurit e kësaj shenje do të kenë fat dhe do të ndihen mjaft komodë nën praninë e partnerit/partneres.

BINJAKET

Binjakët mund të jenë pak të trishtuar, për shkak të monotonisë së kësaj dite. Nuk parashikohet të përjetoni emocione të veçanta. Një mundësi e mirë është të shihni një film aventurë, ose të bisedoni me njerëz që merren me sport.

GAFORJA

Ka gjasa që të shmangni ftesat për të takuar disa persona të caktuar. Nëse është e rëndësishme që të pëmbushni atë që është planifikuar për sot, duhet të lini mënjane kohën e lirë. Shmangni aktivitetin ekstrem, pijet e tepërta dhe thashethemet.

LUANI

Sot Luanët nuk kanë gjasa të gjejnë forca për fitore. Do të ishte mirë tu përkushtoheni punëve të shtëpisë. Mos u përqijni të shmangni deficitin financiar apo probleme të tjera financiare, pasi do të jetë e pamundur. Në fund të ditës do të çodoheni duke biseduar me familjarët.

VIRGJERESHA

Nuk rekomandohet që të kërkonti ndihmë apo këshilla këtë të shtunë. Pjesa tjetër e fundjavës prëmton rrijat shumë emocionale pozitive. Udhëtime dhe përkrahje janë të mirëpritura. Përfaqësitë marrëdhënies personale, nuk është dita e duhur për të bërë deklaratë dashurie.

PESHORJA

Është e mundur që disa prej jush do të vendosin të transformojnë jetën personale. Kur të hyri në këtë rrugë, mos harroni të llogarisni rreziket potenciale. Në mbrëmje ka gjasa të flirtoni me dikë që ka shprehur interes ndaj jush.

AKREPI

Kohën tuaj të lirë rekomandohet t'ua kushtoni familjarëve dhe të lini mënjane punët e përditshme shtëpiake. Në fund të ditës janë të mundshme grindjet e vogla në familje, ose konfliktet me fqinjët tuaj. Tregohuni më pozitivë ndaj partnerit/partneres suaj.

SHIGJETARI

Sot mund të ketë një arsye të re që ju të ndihni krenarë. Ka gjasa të shpallni fitues në një garë sportive. Ndoshta mund të zbuloni një talent të ri në muzikë, pikturë, letërsi apo dizajn. Shmangni sportet ekstreme dhe blerjet e nxitura.

BRICJAPI

Bricjapët duhet të tregohen të kujdesshëm me miqtë e tyre të ngushtë. Duhet të vepromi me më seriozitet ndaj disa peshjtëve të rëndësishme. Megjithatë, mund të kërkonti ndihmë në familje për financat tuaja.

UJORI

Ujori sot nuk duhet të kërkojë arsye për të qenë i pakënaqur. Duke u ndjerë të nervozuar, duhet menjëherë të mendoni sesi të dilni nga kjo gjendje. Mendoni pozitivisht dhe mësoni të respektoni ndjenjat e partnerit/partneres suaj.

PESHQIT

Peshqit do të kenë prioritet realizimit e ëndrrës së tyre. Kini besim te vetja dhe mos e humbisni asnjëherë atë. Do të kaloni një mbrëmje të qetë, por pa ndonjë emocion të veçantë.

Pasi nisi 2019 në mënyrën më të mirë, tek Tirana janë kthyer "fantazmat" e dy sezoneve më parë, kur u largua nga Superliga. Rezultatet negative të javëve të fundit e detyrojnë skuadrën e Ardian Memës të mendojë sërish për shpëtimin. Një mision që duket shumë i vështirë në letër: Përveç dëmtimeve, pezullimeve dhe ndeshjeve në shtëpi pa tifozë, trajneri bardheblu i frikësohet edhe aleancave që në futbollin shqiptar nuk janë të panjo-



Tirana shkon në Vlorë pa Ngo e Dajën

Mema: Duhet të gjej qetësi për të punuar, në Vlorë për rezultat pozitiv

hura. "Më shqetësojnë aleancat. Ekipi mund të kthehet të ndeshjet e mira. Duhet të luftojmë për të arritur rezultatet e fazës së tretë. Ekipi ishte i qetë, ndërsa tani gjendja është pak më e rënduar. Më duhet të gjej

qetësi për të punuar. Më shqetësojnë mënyra e lojës në Laç, dolëm nga loja jonë. Nuk kemi arritur të shënojnë, edhe pse topin e kishim ne. Lojtarët ishin të shpërgjendur. Kanë bërë gabime, por duhet të shohim

përpara, sepse vijnë ndeshjet të rëndësishme. Ekipi ka nevojë për pikë dhe jo për lojë të bukur. Pikët janë ato që sjellin qetësi. Më vjen keq ta them, por ekipi duhet të largohet nga fundi i tabelës. Synimi tjetër është Kupa,

por fillimisht duhet që Tirana të shpëtojë. Matematikisht çdo gjë është e hapur, mund të kualifikohemi në Europë edhe nga kampionati, por duhet të shohim vazhdimësinë. Ka një trajner të mirë me të cilin kam punuar. Është ekip i mirë. Do mundohemi të jemi në ekuilibër për të mos pësuar gol dhe të mendojmë për rezultat pozitiv. Duhet të përgatis ekipin nga ana psikologjike. Nuk kemi çfarë të humbasim. Duhet të bëjmë detyrat në çdo ndeshje".

Nga Luftëtari te Luftëtari, të kuqtë synojnë fitoren për të lënë pas shpine eliminimin në Kupë

Eliminimi në Kupë nuk është pritur mirë jo vetëm nga Gaz Demi, por dhe nga vetë trajneri Gega. Askush nuk dëshiron të humbasë, por ndryshe nga presidenti, Gega e ka më të prekshëm ambientin dhe situatën ku ndodheshin të kuqtë, një humbje nuk mund të zhbëjë gjithçka të mirë që kanë arritur deri më tani. Nga Luftëtari te Luftëtari gjërat ndryshojnë shumë në kampionat, të shtunën luhet një tjetër muzikë, një finale për Gegën:

Ku ndryshon Partizani në Kupë dhe në kampionat?

Ka pasur ndryshime në përbërje në radhë të parë. Përveç lodhjes fizike kemi pasur edhe mungesa të rëndësishme. Ka një lodhje fizike, por edhe impenjimi nuk ka qenë në nivele që kemi treguar në kampionat.

Sa ju shqetësojnë mungesat?

Kemi pasur mungesa, kanë qenë të shumta. Do të rikthehen lojtarë të rëndësishëm. Kemi bërë ndeshje të ngjeshura. Një pjesë e madhe s'kanë bërë pushim që nga fillimi. Kam besim që gjërat do të shkojnë mirë nesër.

Cfarë problemi pati me Asanin dhe Trashin?

Asani gjatë gjithë kohës nuk ishte i kënaqur me lojën, me veten e tij. Ka kualitet, kontribut të jashtëzakonshëm. Momente të caktuara shpërthen, e ka me veten e tij. Mënyra si reagoi nuk është e këndshme. Kam biseduar me të, rëndësi ka mos të përsëriten.

Si është çështja e gjobës?

Për sa i përket presidentit masat janë kompetencat e tij. Është njeri që dëgjon shumë dhe vendos atë që ai di vetë. Është marrëveshje që objektivat duhet të arrihen. Besoj se është e drejtë. Të dy lojtarët do të jenë në fushë, sepse s'kanë bërë asgjë për mos të qenë. Kemi edhe 9 finale që janë finale për ne

Lodhja fizike apo mendore, kush shqetëson?

Lodhja fizike ndikon te mendorja. Me Kukësin kish të lodhje mendore, edhe presion. E kaluam me sukses.

Skënder Gega: Jemi pa aleatë, fitojmë ndaj gjirokastritëve

Timonieri i Partizanit shpjegon edhe çështjen e gjobës



Në Gjirokastër reaguam më zbehtë. Nesër do të jemi po ata që kemi qenë deri tani.

Skuadrat tani luajnë për objektiva, motivohen më tepër...

Jam trajner i Partizanit. Teknikisht i marr gjërat parasysh. Pjesa tjetër i takon klubit. Nuk kemi marrëveshje dhe aleancë me asnjë njeri. Pjesën tjetër nuk e kontrollojmë ne. Ne kemi bërë punë për të arritur deri këtu.

Eliminimi nga Kupa do të ndikojë tek ekipi?

I ka të dyja medaljet. Personalisht nuk kam qejf të humbas as miqësore. Nuk bëmë zgjedhjet e duhura, por lodhja qëndron. Nuk do të mendojmë për Kupën, 150% do të jemi vetëm te kampionati. Besoj se jemi më afër se gjithë të tjerët për kampion. E kemi ëndërr dhe do të mundohemi ta bëjmë realitet. Gjirokastra është finale për mua.

10 lojtarë kanë luajtur mbi 1200 minuta, ka hendek?

Mes kësaj 11-çe ose 12-çe ka diferencë. Ky grup i parë janë ata që na kanë sjellë

këtu. Edhe të tjerët kanë bërë të pamundur për të na sjellë këtu. Ka të rinj që duhet të aktivizohen. Nesër do të fusim grupin më të mirë.

Sezoni më i dhunshëm në Superiore...

Nuk jam në gjendje të them, është hera që jam

këtu. Jam komod këtu, nuk shprehet njeri dhunshëm. Pjesa tjetër nuk më takon mua. Edhe tifozët tonë, jemi munduar të jemi të qetë. Pjesa tjetër më vjen keqardhje.

Nuk është puna ime, por do të doja të mos ndodhte gjë.

Kundërshtari më i fortë,

Kukësi apo vetë Partizani?

Ne luajmë me kundërshtarë. Vetes sonë mund ta dëmtojmë nga performancat. Pjesa tjetër janë kundërshtarët. Kam respekt për të gjithë. Kampionati nuk ka diferencë të mëdha.

Kur rikthehen të dëmtuarit?

Hila është rikthyer dje. Hebah dhe Bardhi janë në terapi. Bardhi ka një provë sot. Më vjen keq për të dy sepse kanë kontribuar sepse kanë bërë kilometra pa fund, shpresoj të rikuperohen. Hebah ka pasur tërheqje muskulare. Do edhe 4 javë të rikuperohet 100%.

Si është gjendja e skuadrës?

Të shkosh në Gjirokastër dhe të kthehesh me humbje nuk është gjë e mirë. Duhet të marrim përgjegjësitë, unë i pari. Jemi në ambient komod. Jemi në rrugën e duhur, kam plot besim. Do ia dalim.

TAKIMI



Gati shkëmbimi me Junajtidin. Reali jep Bejl dhe Kros për Pol Pogba

Lajmin e konfirmon gazeta më e madhe spanjolle "Marca", e cila në numrin e saj të ditës së sotme shkruan se drejtuesit më të lartë të Real Madridit do të kontaktojnë Manchester United për të caktuar një takim për Pol Pogba. Sipas asaj që shkruan gazeta spanjolle, Zidan dhe Pogba besojnë se është koha për të qenë në të njëjtin ekip dhe janë gati ta nisin që nga sezoni i ardhshëm për ta kthyer Real Madridin të dominojë gadishullin Iberik dhe Kontinentin e Vjetër. Nga ana tjetër Solskajer është i interesuar për dy lojtarë të Real Madridit: Gareth Bejl dhe Toni Kros. Kjo pritet ta bëjë më të lehtë tratativën për mesfushorin francez, që gjithsesi mbetet ende në baza hipotetike.

Interi, Marota bën gati revolucionin e madh




bëjnë më pjesë në planet e Marotës dhe do të shoqërojnë trajnerin Spaleti, i cili gjithashtu ka mbërritur në finish me stolin që pritet t'i besohet një emri tjetër dhe më konkretisht një beniamini të Marotës, Antonio Kontes.

Përkundrazi, besimin për një tjetër sezon me fanellën zikaltër e kanë fituar Azamoh, De Vrij, Skrinar dhe D'Ambrozio, ndërsa repartit të prapavijës pritet t'i shtohet edhe urgjuajani Diego Godin.

Administratori i deleguar ka bërë gati listën e lojtarëve që do të largohen në verë nga skuadra zikaltër dhe emrat janë të gjithë sugjestionues, Ikardi mbi të gjitha. Sulmuesi argjentinas është thyer përfundimisht me ambientin në "Apiano Xhentile" dhe do të përdoret për të arktuar sa më shumë, të cilat do të investohen të gjitha në merkato. Edhe Ivan Perisic ka treg, kroati kërkoi të largohet që në janar te Manchester Junajtidi, por duket se anglezët nuk do të presin gjatë pasi Perisic do të jetë i tyri në qershor për shifrën e duhur. Të ikur janë dhe Zhao Miranda, Miranda, Borha Valero dhe Kandreva, të katërt nuk

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë kursimi.
- Ylli i Nostradamus.
- Tamam pa kufij.
- Ross këngëtare.
- I lashtë.
- Eshhtë Aleanca ku sapoi kemi aderuar.
- Kufijtë e lëvizjes
- I ka tek plepi.
- Paguhen për shërbim.
- Fillojnë lejen.
- Kufizojnë trotuarët.
- Bëjnë karrierë në parti.
- Thahet me bonifikim.
- Mund të jetë unik një i tillë .
- Preka komik shkordran.
- Fund dhjetori.
- Fillojnë aksionin.

- Ente Operative Tiranë
- Agjenci Ajrore Durrës.
- Një pjesë e dimensioneve.
- Eshhtë përfaqësuesja e Adriam Mutu.
- Kalimi në ekstreme.
- Eshhtë e re pas Krishtit.
- Shkruhet për të mos vazhduar më.
- Si i gjithë
- Kush e thotë lutet.
- Kufij elementi.
- Ishtë nrya që preu Aleksandri i Madh.
- Një pjesë e titaneve.
- Mund të jetë kundërmuese.
- Pak titanike.

VERTIKAL

- Si i përshtatëshëm.
- Mund të jenë fetare.
- Ai i kuq e ka një huq.
- Pak analogji.
- Eshhtë metri i roboqepësist.
- Në hyrje të oazit.
- Arte pa re.
- Arthur që qe dramaturg.
- Janë boshte.
- Michelangelo regjisor.
- Mund të bëjë stil të lirë .
- Ishin monedhe të Tobias.
- Eshhtë bas me katër tela.
- Pak efikasitet.
- Eshhtë marrëveshje me nota.
- Ishtë babai i Akillit.
- Fillojnë nazet.
- Në krye të kuadrove.
- Eshhtë faqe muri.
- Një apendisit i menjëhershëm.
- Kurosawa që qe regjisor.
- Writen nga espada.
- Eshhtë shtet aziatik.
- Eduoard piktor.
- Një transporti është kamioni.
- Uni i Freud.
- Një cigan.
- Fundi i një samuraj.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- Fillojnë panikun.
- Gibson aktor.
- Në mes të cogito dhe sum e thën nga Descartes.
- Mund të jetë trofe.
- Janë vendet si Katari
- Maureen që qe aktore.
- Janë kundërmuese.
- Mund të fitojnë etapa.
- Ushtojnë nga "ola".
- Një thirrje
- Janë ministritë.
- Një rrugë në Paris.
- Markë cigareje.
- Eshhtë ngjinja.
- Ricciarelli soprano.


- Fillojnë sefte.
- Ente Ekonomike Sarandë.
- Mbyllin një ditar.
- Satelit i Jupiterit
- I ka tek Luani.
- Boldi komik italian.
- Eshhtë kolana në filma
- Kush e thotë lutet.
- Oxa këngëtare.
- Inicialet e Nolte aktor.
- Eshhtë tokë që... fitohet.
- Një... gjermane.

VERTIKAL


- Një votë në favor.
- Filozofi me eksperimentin e gomarit.
- Në hyrje makinës.
- Fillojnë lehtë.
- Irlanda në Dublin.
- Eshhtë edhe ajo e historisë.
- Një pjesë e gamiljeve
- Notat pa kufij.
- Ishin komitë.
- Ka kryeqytet Islamabad.
- Don... i Interpretuar nga Terence
- Mbyllin aktet.
- Janë përmasa.
- Gjysma e lutjes.
- Castellitto aktor.
- Inicialat e Dalí, piktor.
- Tanita këngëtare.
- Eshhtë trysni
- Në hyrje të Europës.
- Janë rrobat për t'u larë.
- Bën mëza.
- Moreau aktore.
- Janë thika.
- Një pjesë e satelitit.
- Janë teke në sende.
- Pak marramendëse.
- I ka tek zdapi.
- Inicialet e Nolte-s.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

6	9		3					8
	1		5	2				
		7				6	3	1
		5	2	6		1	9	
	3		9		4		7	
	4	2		5	1	8		
4	5	3				7		
				7	8		1	
8				5		2	9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	2	6	5	4	7	3	8	9
5	3	9	6	1	8	7	4	2
4	7	8	2	9	3	1	5	6
3	9	1	8	6	4	2	7	5
6	8	5	1	7	2	4	9	3
7	4	2	9	3	5	6	1	8
2	1	4	3	8	9	5	6	7
8	5	7	4	2	6	9	3	1
9	6	3	7	5	1	8	2	4

Argëtim filozofik

- Mos dashuro dhe as mos urre, mos premo dhe as mos beso verbërisht.

- Nëse një ditë do të më kërkosh dhe nuk do të ekzistoj më... vetëm mos harro se dikur isha atje për ty ... dhe ti nuk dite të më vlerësosh .

*- Por do të vijë çasti kur vetmia do të të lodhë, kur krenaria jote do të përkulet dhe guxim yt do të dërmohet. Atëherë do të bërtasësh "Jam vetëm".

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	7	2		7	3		13		2	
2	7	5			8	4	3	5	7	2	6
7		3	1	9	1	6	5	10	6	2	6
	3	5	8	2	3	5	6	1	7	5	
12	5	13	5	10	1	7		6		13	
2	7	18		5	11	2	6	5	8	2	6
8	2	6	2		2	1	8	5	11	1	
1	6	8		17	9	5	7	2		9	
3	1	5		8	2	16			2	7	1
2				3	2	6	5	9	2		13
6	2	7	2			3	7	8	5	6	7
	3	4	8	5	19	1	5		3	5	2

S	T	R	I	P	B	B	V	O	T	A	
H	E	R	O	I	N	A	O	V	E	R	
S	A	S	S	N	R	V	R	T			
U	T	S	H	T	E	T	E	R	O	R	E
B	L	I	T	E	R	A	T	U	R	A	T
M	I	N	E	R	A	L	E	T	C		
K	A	L	O	R	E	S	I	T	H	A	V
C	A	R	I	S	T	I	N	H	T	L	
V	H	I	M	I	M	I	K	E			
R	A	M	E	T	N	A	A	R	R		
A	D	R	E	S	E	I	T	A	L	I	A
P	O	L	E	M	I	K	A	S	E	A	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	T	A		H	E	L	M	E	T		
A	R	R	V	E	D	D	E	P	P			
P	A	R	A	L	E	L	E	T	L	E	R	
P	O	L	I	F	E	M	I	O	L	E		
E	M	I	L	E	Z	O	L	E	T	K		
T	A	I	R	A	T	E	R	K	Z	E		
E	R	A	I	D	E	M	R	I	T	S		
H	I	M	A	E	S	T	R	O	D	E		
T	A	L	E	N	T	E	T	A	R	E		
E	K	R	A	H	O	R	A	R	I	A		
S	I	P	R	I	T	A	T	A	T	R		
K	A	P	A	N	O	N	E	T	L	A	L	A
D	I	S	K	O	T	E	K	A	T	A	P	
R	O	M	A	N	A	R	G	O	S	A		
E	N	T	G	N	I	R	H	R				
W	M	O	N	O	G	R	A	F	I	A	A	
P	E	L	E	G	R	I	N	A	Z	H	E	T
P	O	L	I	G	L	O	T	E	T	I	D	E
A	L	K	R	A	H	E	T	K	S	H		
K	E	N	T	E	T	K	A	T	E	T		
E	M	I	L	E	E	N	J	O	M	E	R	
T	I	M	E	R	S	T	A	N	E	T	I	
A	K	S	E	R	I	O	Z	E	R	A	M	
T	E	O	T	R	A	Z	J	A	R	R	I	

FJALËKRYQI (1)



FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- *- Gjërata më të bukura në jetë nuk i shohim me sy ... por i ndjejmë me zemër !!!
- Përpjekja për të sjellë parajsën në tokë, udhëheq pa përjashtim, në ferr.
- Kënaqësia më e madhe në natyrë, është mungesa e njerëzve.
- *- Kur ju mendoni atë që keni humbur, ju humbni atë që jetoni.

